

**Zëri i votuesve**  
**Çështje të rëndësishme komunale**

Shtator 2000

Prishtinë, Kosovë

*Punë e përbashkët e Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së,*

*Drejtimi redaktorial:*

**Peter Collier dhe Brett Jones**

*Përkthyes:*

**Leon Malazogu, Flamure Selimi-Lahu**

*Faqosja dhe kopertina:*

**Driton Kamberi**

*Shtypi:*

**“INTERPRESS R. Company”**

*Në bashkëpunim me:*

**Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Departamenti i Demokratizimit**

*Me mbështetjen dhe ndihmën e:*

**Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)**  
**Shoqatës “Nëna Tereze”**

**Shënimet e tjera janë siguruar nga:**

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)

Agjencia Evropiane për Rindërtim

Organizata Botërore e Shëndetit (WHO)

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM)

Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)

Qendra Rajonale për Ambientin për Evropën Qendrore dhe Lindore

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG)

Grupi Ndërkombëtar Menagjues (IMG)

# Përmbajtja

1. Pasqyrë përmbledhëse .....	5
2. Parathënie .....	3
3. Hyrje .....	9
4. Prioritetet e votuesve .....	11
· Shëndetësia .....	12
· Arsimi .....	16
· Zhvillimi ekonomik/punësimi .....	20
· Uji .....	23
· Shërbimet Sociale .....	26
· Rryma .....	29
· Banimi .....	31
· Rrugët .....	33
· Ambienti .....	35
· Mbeturinat .....	37
· Kanalizimi .....	39
· Mbrojtja e pakicave .....	40
· Telekomunikimi/Posta .....	42
· Kultura .....	43
· Transporti publik .....	45
· Çështje të tjera të hapura .....	46
6. Pikëpamjet e pakicave .....	48
7. Aneks: Prioritetet sipas rajoneve .....	51

## Parathënie

Derisa e botojmë këtë raport – *Zëri i votuesve, Çështje të rëndësishme komunale* – Kosova qëndron para zgjedhjeve të para demokratike. Për të parën herë kosovarët kanë rastin që të marrin pjesë në një proces zgjedhor të lirë, të drejtë e të hapur dhe në një demokraci vendore përfaqësuese dhe vërtet përpjesëtimore. Fuqia do të bartet në duar të tjera, vendimet do të decentralizohen dhe procesi i vendosjes së vetëqeverisjes kuptimplotë në Kosovë do të fillojë. Dhe, do të fillojë atje ku gjithmonë duhet të fillojë – në nivelin komunal. Vlera e vërtetë e demokracisë qëndron në dhënien e përgjigjeve shqetësimeve të bashkësive vendore dhe nevojave të njerëzve që jetojnë aty. Janë bregat, shpresat dhe problemet e tyre ato që duhet të jenë pikënisje për politikanët dhe udhërrëfyes në drejtimin e fushatave politike. Fundja, votuesit janë ata që “e kontrollojnë” demokracinë. Nuk është qeveria por të qeverisurit janë ata që e thonë fjalën e fundit.

Në këtë frymë dhe brenda kësaj kornize pra duhet të lexohet ky raport – si pjesë e një përpjekjeje më të gjërë për të theksuar çështjet vendore dhe për të kthyer vëmendjen drejt pikëpamjeve të trupit zgjedhor. Por, thënë në mënyrë më të specifikuar, të kthehet vëmendja e kandidatëve politik kosovarë kah pikëpamjet e votuesve. Në kohën kur zuri fill ideja për këtë raport, në pranverë të këtij viti, nga Departamenti i Demokratizimit të OSBE-së, qëllimi kryesor ishte që të inicohet një debat midis trupit zgjedhor dhe politikanëve. Ne shpesojmë se ky lloj debati do të afrojë të dyja palët dhe agjendat e tyre. Suksesi ynë do të matet me fillimin e reagimit të partive në shqetësimet e votuesve me programe të specifikuar dhe rrjedhimisht votuesve kështu do të ofrohet një zgjidhje e njëmendtë në kutinë zgjedhore.

Pos falënderimeve drejtuar USAID-it, Këshillit për Përparimin e Komuniteteve dhe shoqatës “Nëna Tereze”, OSBE-ja i falënderon të gjithë njerëzit që dhanë kontributin e tyre në këtë projekt dhe të cilët e ngritën zërin e tyre në emër të popullit të Kosovës. OSBE-ja shpreson se ky botim do të lexohet gjithandej dhe se do të jetë i dobishëm për të gjitha partitë politike, organizatat vendore e ato ndërkombëtare dhe natyrisht, për popullin e Kosovës.



**Ambasadori Daan Everts**  
**Kryetar i Misionit të OSBE-së në Kosovë**

## Pasqyrë përmbledhëse

Ky botim është përfundim i *projektit Zëri i votuesve të OSBE-së* dhe paraqet çështjet e rëndësishme komunale, pikëpamjet dhe prioritetet e theksuara nga më shumë se një mij njerëz gjithandej Kosovës. Objektivi e këtij projekti si dhe e këtij botimi është të inkurajojë partitë politike dhe kandidatët që të përqendrohen në çështjet specifike që drejtpërsëdrejti shqetësojnë votuesit kosovarë, dhe që ti ofrojë trupit zgjedhor një instrument për të kthyer vëmendjen e kandidatëve politik në diskutime dhe debate informative, të përqëndruara dhe konstruktive.

Për të arritur këtë cak, OSBE-ja ka mbajtur më tepër se shtatëdhjetë mbledhje nëpër vende të ndryshme rreth e qark Kosovës në të cilat është kërkuar nga qytetarët që të radhisin sipas prioriteteve pesëmbëdhjetë çështjet më të rëndësishme të përcaktuara me *Rregulloren e UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë* që këto të jenë kompetencat ose fushat e përgjegjësive për udhëheqësit e zgjedhur komunal, dhe pastaj që të shtjellojnë hollësisht pesë çështjet e veçuara si më të rëndësishmet. Me përjashtime të vogla, mbledhjet ishin efektive dhe përfundimet të qarta dhe të kënaqshme për pjesëmarrësit. Ndonjëherë, çështje më të mëdha politike, siç është statusi përfundimtar i Kosovës dhe përgjegjësitë ose dështimet e bashkësisë ndërkombëtare, ishin temë e diskutimeve; mirëpo, shumica e pjesëmarrësve dëshmuuan se janë plot energji dhe të aftë që të diskutojnë në suaza konkrete se si do të kishin dëshiruar ata që udhëheqësit e tyre komunal të zgjedhur tu qasen çështjeve më të rëndësishme bashkiake.

Në përgjithësi, përfundimin e përshkon një ndjenjë e fortë se populli i Kosovës gjithsesi dëshiron që të lëvizë përpara, të jetë i lirë nga frika dhe nga dhuna, ta shohë shoqërinë duke përparuar dhe se ky popull dëshiron që të arrijë një nivel të tillë modernizimi që mund të krahasohet me atë të pjesëve të tjera të Evropës. Ata e kanë humbur durimin dhe janë të zhgënjyer nga shtrëngimet që sipas tyre e kanë dëmtuar Kosovën ndërkohë që mundësive për zhvillim ekonomik dhe shoqëror u është imponuar infrastruktura jofunksionale. Si nevojë më urgjente, ata e përkufizojnë nevojën për ta tejkaluar luftën e përditshme për shërbime të kufizuara shëndetësore, arsim, mundësi për punësim, shërbime sociale dhe shërbime të tjera publike për të cilat mendojnë se janë thelbësore për një jetë normale. Rrjedhimisht çështjet që më së shpeshti identifikohen si “tepër të rëndësishme” janë shërbimet shëndetësore, arsimi, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, uji dhe shërbimet sociale, me këtë radhitje.

Çështja që më së shumti përmendet si prioritet kryesor është shërbimi shëndetësor. Më saktësisht, njerëzit thonë se nuk ka mjaft spitale apo shtëpi shëndeti që ti shërbejnë

kësaj popullate, dhe se ky problem është më akut në komunitetet rurale të cilat shpesh nuk kanë fare këso shërbime. Por edhe aty ku ka shërbime shëndetësore, ato janë të stërngarkuara, pa personel adekuat, dhe u mungon higjiena, pajimet dhe ilaçet. Gjithashtu brengos edhe rritja e kostos së trajtimeve mjekësore, e sidomos e çmimeve të ilaçeve. Çështjet e që kanë të bëjnë me shëndetin e grave gjithashtu konsiderohen prioritete të rëndësishme. Njëra nga zgjidhjet e propozuara është edhe ndërtimi i më shumë shtëpive të shëndetit nëpër fshatra, subvencione në pagesën e ilaçeve, ngritja e shkallës së vaksinimit dhe të programeve të edukimit shëndetësor.

Arsimi është çështje e dytë sipas prioriteteve dhe e shikuar të jetë jo vetëm vitale për përcjellje të njohurive dhe shkathtësive tek të rinjtë, por edhe si bazë mbi të cilën shoqëritë moderne, demokratike dhe të civilizuara ndërtohen. Njerëzit rregullisht i shohin shumë probleme të tanishme si rezultat i problemeve në arsim dhe të papunësisë me kriminalitet në mesin e të rinjve. Shumë nga ata pajtohen se ka pasur përparim në rindërtimin e shkollave, mirëpo thuhet se edhe ato shkolla të shkatërruara që kanë mbetur ashtu siç janë duhet të rindërtohen, duhet të ndërtohen shkolla të reja, dhe të gjitha duhet të pajisen ashtu që të sajojnë ambient të vërtetë mësimi. Gjithashtu është prezent një shqetësim tjetër i madh që lidhet me dekurajimin e të rinjve për mosvijimin e mësimi apo pamundësinë për vijim, sidomos të nxënësve të cilëve nuk u lejohet regjistrimi në shkolla të mesme, fëmijëve që jetojnë në vende të izoluar rurale, dhe grave. Ekziston konsensusi se standardet arsimore duhet të ngriten në nivel të atyre të Evropës perëndimore, puna e arsimtarëve të përmirësohet, dhe që planprogrami të riformësohet, të depolitizohet dhe të profesionalizohet. Ngritja si e nivelit të pagave të arsimtarëve ashtu edhe të nivelit të përgjegjësisë së tyre është identifikuar si hap i parë drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit.

Nevoja që të shtohen vendet për punësim dhe që të përmirësohen kushtet për zhvillim ekonomik zen vend qendror midis shqetësimeve të kosovarëve. Sikurse edhe arsimi, papunësia shpesh konsiderohet si shkaktar i një numri të problemeve sociale duke e përfshirë këtu krimin. Shumica mendojnë se revitalizimi ekonomik është kyç për një përparim të mëtejshëm të Kosovës. Fabrikat ekzistojnë, ata thonë, mirëpo shumica nuk punojnë dhe janë duke u shkatërruar, dhe derisa Kosova ka pasuri natyrore, ato nuk mund to shfrytëzohen. Privatizimi, dhe mbledhja e tatimeve nga importi për të mbrojtur ndërmarrjet vendore dhe joshja e investimeve të huaja janë sipas tyre zgjidhjet kyçe; mirëpo, në mënyrë që të tërhiqen investimet e huaja, parakushtet kryesisht janë funksionimi më i mirë i sistemit bankar, furnizimi me rrymë dhe përmirësimet tjera në infrastrukturë.

Mungesa e ujit të pijshëm gjithashtu shtrohet si problem serioz gjithandej Kosovës. Sidomos nëpër fshatra, përditshmërinë e përshkon lufta e vazhdueshme për të arritur deri tek sasi të kufizuara të ujit. Të tjerët e theksojnë rëndësinë e ujit për kafshët, për prodhimin e ushqimit dhe për industrinë. Uji i papastër apo i kontaminuar është gjithashtu problem kryesor, dhe shpeshherë konsiderohet të jetë shkaktar i sëmundjeve. Rëndom mendohet se problemi nuk qëndron në mungesën e ujit, por në mungesën e sistemeve që do të duhej të sillnin ujin aty ku ai është i nevojshëm. Kompletimi apo ndërtimi i sistemeve të tilla, duke e përfshirë këtu edhe ato për ujitje, janë zgjidhjet më të numërta të cekura për këtë problem.

Çështja e shërbimeve sociale, prioriteti i pestë, pati përgjigje direkte: "të rivendosen pensionet, të sigurohet ndihma sociale për të vejat, invalidët, si dhe për bonjakët." Njerëzit i theksojnë përpjekjet që ka bërë UNMIK-u në këtë drejtim mirëpo të gjithë

janë të një fjale se ato janë të pamjaftueshme. Rivendosja e pensioneve dhe përmirësimi i shërbimeve sociale konsiderohen prioritete urgjente. Përveç ndihmës së paraparë nga qendrat për punë sociale të UNMIK-ut, shumica propozojnë që duhet të vilen tatimet për të krijuar fondet e domosdoshme.

Rryma zë vendin e gjashtë në listen e prioriteteve dhe është çështje brengosëse për pothuajse çdo banor të Kosovës. Njerëzit ofrojnë dy të dhëna të përgjithshme për të argumentuar përse është thelbësor furnizimi i rregullt me rrymë elektrike: e para, konsiderohet se ai është parakusht themelor për jetë normale; e dyta, shumë e konsiderojnë këtë si parakusht fundamental për zhvillimin ekonomik dhe për tërheqjen e investimeve të huaja. Për ta zgjidhur këtë problem, njerëzit janë të bindur se duhet të bëhen investime të mëdha në mënyrë që të rimëkëmben centralet elektrike dhe rrjeti përcues i rrymës, se duhet të punësohen ekspertë që do të mirëmbanin sistemin si duhet, dhe se qytetarët duhet të paguajnë faturat e tyre për shfrytëzimin e rrymës.

Strehimi zë vend të lartë në listën e prioriteteve të çështjeve të rëndësishme bashkiake, dhe mendim i përgjithshëm është se shpejtësia e rindërtimit nuk kënaq. Në prag të dimrit, kjo çështje diskutohet me urgjencë, sidomos në rajonin e Pec/Pejës pasi atje shkatërrimet nga lufta ishin më të mëdhatë. Ata që kanë mbetur pa shtëpi të tyre, i përshkruajnë kushtet e rënda dhe shpeshherë të pashëndetshme si dhe vështirësitë me të cilat duhet përballur derisa familje të mëdha jetojnë në një shtëpi të vogël. Ata shprehin gatishmërinë që të rindërtojnë shtëpitë e tyre mirëpo ballafaqohen me mungesë të materialeve apo të mjeteve për të blerë ato. Andaj, ata mendojnë se bashkësia ndërkombëtare dhe udhëheqësit e zgjedhur komunal duhet ti kushtojnë më tepër rëndësi rindërtimit të shtëpive para dimrit.

Prioriteti i tetë janë rrugët. Kryesisht mendohet se pa rrugë më të mira, njerëzit nuk mund të lëvizin lehtë prej një vendi në vendin tjetër, dhe nuk mund të transportojnë të mirat, materialet, dhe resurset prej të cilave janë të varur ata dhe ekonomia. Kështu që, sikurse kur flitej për rrymën, shumica mendojnë se zhvillimi ekonomik varet nga zhvillimi dhe mirëmbajtja e një rrjeti adekuat rrugor dhe transportues. Gjithashtu, qytetarët shpalosin shqetësimet e tyre për rritjen e problemeve në komunikacion. Zgjidhja e paraparë është që të rregullohen rrugët dhe që këto punë të financohen nga tatimet.

Pas rrugëve pasojnë respektivisht, mbrojtja e ambientit, mbledhja e mbeturinave dhe kanalizimi. Shqetësimet që shpalosen lidhur me mbrojtjen e ambientit shpesh kanë të bëjnë me rreziqet për shëndetin, dhe zgjidhjet e përmendura përfshijnë një program më intensiv të vetëdijësimit të njerëzve dhe pranimit në shkallë më të lartë të përgjegjësisë personale dhe kolektive për mbrojtjen e ambientit. Mbledhja e mbeturinave rreshtohet e dhjeta, mirëpo është çështje për të cilën shkruhen një varg komentesh nga qytetarët e brengosur. Problemet kyçe të identifikuar janë hedhja e mbeturinave gjithandej nëpër venbanime mungesa e vendeve të posaçme për asgjësimin e mbeturinave apo mungesa e mundësive për reciklim, kërcënimet për shëndetin dhe higjienën, dhe përsëri, mungesa e vetëdijes për ambientin njashtu si dhe dëmtimi i vet ambientit. Problemet e kanalizimit gjithashtu konsiderohen si kërcënim për shëndetin dhe ambientin, dhe se zgjidhjet e identifikuar janë metodat më të përshtatshme për asgjësim dhe ndërtimi i qendrave për trajtim.

Mbrojtja e pakicave zë vendin e dymbëdhjetë midis pesëmbëdhjetë çështjeve më të rëndësishme bashkiake. Derisa kjo çështje radhitet e katërta në mesin e pjesëmarrësve

## Zëri i votuesve

Rradhitja	Çështje	Pikë (1-3 shkallë)
1	Shërbimet shëndetësore	<b>2.67</b>
2	Arsimi	<b>2.62</b>
3	Zhvillimi ekonomik/punësimi	<b>2.50</b>
4	Uji	<b>2.35</b>
5	Shërbimet sociale	<b>2.31</b>
6	Rryma	<b>2.30</b>
7	Strehimi	<b>2.21</b>
8	Rrugët	<b>2.02</b>
9	Mbrojtja e ambientit	<b>1.81</b>
10	Mbledhja e bërllokut	<b>1.67</b>
11	Kanalizimi	<b>1.55</b>
12	Mbrojtja e pakicave	<b>1.52</b>
13	Telekomunikimet dhe posta	<b>1.50</b>
14	Aktivitetet kulturore	<b>1.38</b>
15	Transporti publik	<b>1.24</b>

minoritar, pas shëndetit, pikëpa-mjet e minoriteve shtjellohen në një pjesë të veçantë. Në pjesën më të madhe të diskutimeve kryesisht theksohet mbrojtja e pakicave si përgjegjësi morale dhe etike e të gjithë anëtarëve të një shoqërie që të përkuqjedesen për të drejtat dhe sigurinë e secilit, sidomos të atyre më të rrezikuarve. Shumë nga disku-tuesit e shohin lirinë dhe sigurinë e të gjithëve si parakusht për zhvillimin e një sho-

qërie demo- kratike, dhe disa nga ata e përshkruajnë një ndjenjë të tejldhjes emotive nga një periudhë e gjatë e urrejtjes dhe dhunës së përjetuar dhe e shprehin dëshirën për të ikur nga tragjeditë e kaluara dhe për të përqaftuar idenë që të gjithë njerëzit të jetojnë në liri dhe siguri.

Edhe pse telekomunikimi dhe posta, aktivitetet kulturore, dhe transporti publik kanë prioritet më të ulët se pesëmbëdhjetë çështjet më lartë, duhet të ceket se shumë vetë shpesh insistojnë që të pesëmbëdhjetë çështjet janë njëlloj të rëndësishme dhe se rradhitja e tyre si “më pak të rëndësishme” është e vështirë. Mungesa e lidhjeve telefonike, dhe mungesa e një sistemi postar që funksionon më gjërë, dhe sidomos nëpër fshatra, e vështirëson kontaktimin me të tjerët. Shumë qytetarë të cilët e shpalosin temën e kulturës theksojnë vlerat jetëndërtuese dhe terapeutike të aktiviteteve siç janë sporti, muzika dhe vallëzimi. Ata janë të një fjale se këto aktivitete kishin rëndësi të veçantë në orientimin e zhvillimit të të rinjëve në drejtime pozitive. Së fundi, transporti publik është një çështje me rëndësi të veçantë sidomos për disa që jetojnë në ambiente rurale dhe të cilët janë të zhgënjyer nga funksionimi i çrregullt i shërbimeve.

Më 28 tetor të këtij viti, populli i Kosovës do ta ketë rastin që ti zgjedhë udheqësit komunal në zgjedhjet demokratike. Atje ku demokraci do të thotë qeverisje nga populli, demokracia përfaqësuese ekziston kur njerëzit i zgjedhin anëtarët nga komuniteti i tyre që tu shërbejnë interesave të tyre kolektive. Që një sistem i tillë të funksionojë, njerëzit duhet të jenë të informuar për ata që do ti përfaqësojnë dhe çfarë do të bëjnë këta pasi që të jenë zgjedhur, dhe ata që zgjedhen duhet të jenë të vendosur dhe të aftë që tu shërbejnë interesave të popullit. Andaj, shpresa dhe sfida që e shoqërojnë lindjen e demokracisë janë njëloj të mëdha.

Qëllimi i *Zërit të votuesve* është që, tua pasqyrojë kandidatëve për administratën komunale por edhe opinionit publik çështjet më të rëndësishme komunale dhe prioritetet e shprehura nga populli i Kosovës. Për më tepër, qëllimi është që qytetarët të inkurajohen që ti mbajnë politikanët përgjegjës ndaj vullnetit të tyre, dhe në anën tjetër, ti ngas këta politikanë që ti përgjigjen popullit të cilit do ti shërbejnë me propozime të qarta dhe konkrete duke përshkruar se si do tu qaseshin ata çështjeve më të rëndësishme për komunitetet e tyre.

Për ta arritur këtë qëllim, Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së që nga fillimi i këtij viti u mundua që të grumbullojë informata lidhur me çështjet që brengosin votuesit dhe përgjatë verës mbahti mbi shtatëdhjetë mbledhje nëpër venbanime gjithandej Kosovës. Me ndihmën e pakursyeshme të Zyrës për Iniciativa Tranzicioni të USAID-it, Këshillave të bashkangjitura për Përparimin e Bashkësisë, shoqatës “Nëna Tereze”, dhe të një varg organizatash vendore dhe ndërkombëtare, mbi një mij persona morën pjesë në këto mbledhje. Në mesin e tyre kishte individë të të gjitha moshave, si dhe me prejardhje e profesione të ndryshme, si dhe grupe grash, të rinjesh, bujqish, romësh, hashkalinjesh, turqish, serbësh dhe boshnjakësh.

Metodologjia e grumbullimit të informatave ishte mjaft e thjeshtë. Në çdo mbledhje, njerëzve u thuhej së pari që ti caktojnë prioritetet ose ti radhisin të pesëmbëdhjetë çështjet e përcaktuara me *Rregulloren e UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë* në tri kategori për kah rëndësia që do të jenë kompetencat apo fushat e përgjegjësisë për liderët e zgjedhur komunal. Pas përcaktimit se cilat janë pesë çështjet më të rëndësishme, pjesëmarrësit pastaj e shtjellonin secilën prej tyre detajisht duke identifikuar problemet ekzistuese dhe zgjidhjet e mundshme. Çdonjenit i ofrohej mundësia që të flasë për probleme të tjera që nuk ishin radhitur midis atyre pesëmbëdhjetë si edhe të komentojë me shkrim këto tri prioritete më të mëdha sipas vlerësimit të tij apo të saj. Të pesëmbëdhjetë çështjet, ose kompetencat, të pasqyruara



## Zëri i votuesve

---

sipas Rregullores së UNMIK-ut janë:

1. Shërbimet shëndetësore	6. Aktivitetet kulturore	11. Rryma
2. Arsimi	7. Uji	12. Telekomunikimet/ Sistemi postar
3. Shërbimet sociale	8. Kanalizimi	13. Mbrojtja e ambientit
4. Mbledhja e mbeturinave	9. Rrugët	14. Zhvillimi ekonomik/Punësimi
5. Strehimi	10. Transporti publik	15. Mbrojtja e pakicave

Në përgjithësi, përgjigjet e pjesëmarrësve kishin një frymë tepër pozitive. Njerëzit treguan nivel shumë të lartë të angazhimit qytetar , e vlerësonin lartë mundësinë që të dëgjohen nga të tjerët dhe ishin të gatshëm që të marrin pjesë në një proces të ndërtimit të demokracisë. Pjesëmarrësit ndonjëherë shtjellonin çështje më të mëdha politike, siç është statusi përfundimtar i Kosovës, ose diskutonin mbi përgjegjësinë apo dështimet e bashkësisë ndërkombëtare, mirëpo shumica ishin të gatshëm që të flasin mbi problemet specifike dhe mbi brengat në bashkësitë e tyre dhe se çfarë dëshirojnë që liderët e tyre të bëjnë për ta.

Sikurse tregon vetë titulli, *Zëri i votuesve* shpreh idetë, mendimet dhe pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës, dhe jo ato të OSBE-së ose të redaktorëve të këtij botimi. Gjithashtu duhet të vihet në pah se edhe pse është shkruar mund i madh për të grumbulluar një spektër të gjërë pikëpamjesh që janë reprezentative për popullatën në tërësi dhe që këto pikëpamje të pasqyrohen në mënyrë të balancuar, të saktë dhe të drejtë, megjithatë ky nuk është as studim shkencor e as demografik, dhe se të dhënat e paraqitura këtu nuk kanë për qëllim që të zgjidhin debatin për prioritetet e bashkësisë; por, mendimi prijës ishte që ato të kontribuojnë duke i dhënë brumë, kahje dhe peshë rëndësisë së vazhdimit të një debati të këfillë.

## Prioritetet e votuesve

Më poshtë janë paraqitur pesëmbëdhjetë çështjet bashkiake të radhitura sipas urgjencës dhe rëndësisë për popullin e Kosovës. Për ta sajuar këtë renditje, pjesëmarrësit e mbledhjeve të Zërit të votuesve e vlerësonin secilën çështje si “shumë e rëndësishme” (3 pikë), “e rëndësishme” (2 pikë), ose “më pak e rëndësishme” (1 pikë). Të gjitha vlerësimet më pastaj janë llogaritur së bashku për të arritur deri tek mesatarja e përgjithshme për tërë Kosovën për secilën çështje me pikë nga 1 deri në 3. Kështuqë, shërbimi shëndetësor zë vendin më të lartë me mesatarisht 2.67 pikë kurse transporti publik atë më të ulët me 1.24 pikë.

<b>Rradhitja</b>	<b>Çështje</b>	<b>Pikë (1-3 shkallë)</b>
1	Shërbimet shëndetësore	<b>2.67</b>
2	Arsimi	<b>2.62</b>
3	Zhvillimi ekonomik/punësimi	<b>2.50</b>
4	Uji	<b>2.35</b>
5	Shërbimet sociale	<b>2.31</b>
6	Rryma	<b>2.30</b>
7	Strehimi	<b>2.21</b>
8	Rrugët	<b>2.02</b>
9	Mbrojtja e ambientit	<b>1.81</b>
10	Mbledhja e bërllokut	<b>1.67</b>
11	Kanalizimi	<b>1.55</b>
12	Mbrojtja e pakicave	<b>1.52</b>
13	Telekomunikimet dhe posta	<b>1.50</b>
14	Aktivitetet kulturore	<b>1.38</b>
15	Transporti publik	<b>1.24</b>

# 1. Shërbimi shëndetësor

*Nëpër fshatra e madje edhe nëpër qytete, njerëzit lëngojnë nga sëmundje që janë harruar në botën e civilizuar.*

Mjek, Prishtina/Pristina

Të shumtën e herave, shërbimi shëndetësor identifikohet nga pjesëmarrësit si prioriteti më i lartë, dhe në përgjithësi si parakusht për funksionimin e një shoqërie. Për shkak të rëndësisë që i kushtohet shëndetit dhe kujdesit shëndetësor në Kosovë, njerëzit janë shumë të zëshëm sa i përket të metave që ata i shohin në sistemin e shërbimit shëndetësor dhe në përmirësimet që dëshirojnë të implementohen. Më saktësisht, populli është i brengosur për situatën joadekuate të spitaleve dhe klinikave të Kosovës – pa kurrfarë pajisjesh apo aso të vjetruara, johigjienike dhe të stërbushura – gjithashtu edhe vështirësitë që të arrihet deri tek shërbimet shëndetësore nëpër fshatra. Pjesëmarrësit nuk kanë mundësi që ti paguajnë çmimet e larta të ilaçeve apo të shkojnë nëpër ambulanca private. Ata gjithashtu mendojnë se pagat e mjekëve janë shumë të ulëta në krahasim me rolin vital që ata e luajnë.

Preventiva dhe arsimit shëndetësor gjithashtu janë paraqitur si çështje me rëndësi. Individë mendojnë se shumë probleme shëndetësore në Kosovë shkaktohen nga sanitariet joadekuate; ata duan një shkallë më të lartë të vaksinimit për fëmijët e tyre dhe fushata informative për parandalimin e sëmundjeve. Gjithashtu u paraqit edhe çështja e shtatzënisë së padëshiruar. Është vlerësuar se vetëm një për qind e popullatës kosovare përdor mjete kontraceptive moderne dhe se disa spitale raportojnë secilën ditë numë të barabartë abortimesh dhe lindjesh.<sup>1</sup> Shumë gra mendojnë se duhet të ketë më tepër arsimim shëndetësor për gratë në përgjithësi dhe programe të posaçme për zonat rurale.

## Spitalet dhe pajisjet mjekësore

Një çështje e shpeshtë është se spitalet rajonale dhe klinikat nuk kanë pajime themelore dhe se edhe kur gjinden, ato janë zakonisht të vjetra më se tridhjetë vjet apo edhe më tepër. Mirëmbajtja e përgjithshme është e mjerë, pajtohen njerëzit nga Gjilani/Gnjilane, dhe se ka pak pjesë rezervë kur ndonjë prej pajimeve priset. Siç vihet në pah prej një

---

<sup>1</sup> 1 Helene Lefevre-Cholay, "Maternal, Child and Reproductive Health in Kosovo," (Shëndeti i nënave, i fëmijëve dhe ai reproduktues në Kosovë) World Health Organization; (Tetor 1999).

ekonomisti nga Peja/Pec, "ka shumë nevojë për spitale moderne dhe për pajisje. Nuk dua që të jem i detyruar ta lëshoj Kosovën sa herë që më duhet diçka më tepër se sa trajtim themelor." Këto shqetësime reflektohen në të gjitha komunat. Një avokat nga Peja/Pec shton, "nevojiten më shumë specialista në mënyrë që të rritet efikasiteti brenda sistemit të shërbimit shëndetësor." Sa për pajisjet, një infermiere nga Prishtina/Pristina thotë se aparatet shumë të vjetra të rëntgenit janë "turp" për sistemin shëndetësor të Kosovës. Shqetësime të tjera që paraqiten vende vende janë uji dhe rryma në disa klinika dhe spitale, të cilat, thuhet se e bëjnë të pamundur që të mbahet një nivel i pranueshëm i higjienës. Një grua në Gjakovë/Djakovica është e drejtpërdrejtë kur bëhet fjalë për problemet në sistemin e shërbimit shëndetësor:

*Shpesh spitalet dhe klinikat janë plot insekte dhe ushqimi nuk është i përshtatshëm për konsumim të njerëzve. Dhomat janë të stërmbushura me pacientë. Për ta duhet të përkujdesen familjarët e tyre tërë kohën sepse infermieret kanë tepër punë ose nuk përkujdesen fare. Nganjëherë njerëzit që shkojnë në spital për shërim kthehen më të sëmurë se që kanë qenë kur kanë shkuar, sepse spitalet nuk janë higjienike, kështu që shumë sëmundje mund të përhapen brenda tyre.*

## Shtëpitë e shëndetit dhe bashkësitë rurale

Njerëzit anembanë Kosovës pajtohen se nuk ka mjaft shërbime shëndetësore nëpër fshatra. Edhe pse, përveç spitaleve në Kosovë ekzistojnë 381 ambulanca dhe 42 shtëpi shëndeti, shumë qytetarë janë të brengosur për shkak të largësive të mëdha që duhet të kalojnë për të arritur deri tek shërbimi shëndetësor. "Na duhen më tepër ambulanca nëpër fshatra," shkruan një burrë nga Vitia/Vitina, "sepse jeta në fshat është shumë e vështirë kur nuk ka ndonjë mjek apo infermiere." Banorët e fshatrave më të vogla dhe të izoluara ankohen se nuk kanë se si të arrijnë deri te qendra shëndetësore gjatë dimrit. Banorët e Ferizajt/Urosevac janë të brengosur për fshatrat e izoluara dhe thonë se "përkujdesi shëndetësor në rajonet malore është

## Të dhënat mbi shërbimin shëndetësor

- Një studim i pavarur mbi dëmet në spitale dhe shtëpi shëndeti thotë se prej 465 qendrave shëndetësore (spitale, shtëpi shëndeti dhe ambulanca) në Kosovë, 246 (52.9%) ishin dëmtuar dhe 61 (13.1%) ishin shkatërruar plotësisht.\*
  - Sot ekzistojnë pesë spitale rajonale në Prizren, Gjakovë/Djakovica, Pejë/Pec, Gjiilan/Gnjilane dhe Mitrovicë/a dhe një spital i shkallës së tretë/ mësimdhënës në Prishtinë/Pristina.
  - Kosova ka 2.2 shtretër në 1,000 banorë, krahasuar me mesataren e Bashkësisë Evropiane që është rreth 7.3 shtretër në 1,000 banorë.
  - Rreth 400 shtëpi shëndeti dhe ambulanca ofrojnë shërbime të tjera shëndetësore anembanë Kosovës.\*
  - Në tërë Kosovën funksionojnë 75 ambulanca, numër i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e popullatës.\*\*
  - 13,200 individë punojnë në sektorin e shëndetësisë, prej të cilëve 2,300 janë mjekë dhe 6,000 janë infermierë.\*\*\*
  - Vlerësohet se rreth 70 –75 % të popullatës së Kosovës janë vaksinuar nga sëmundjet e shpeshta të fëmijëve, një prej shkallëve më të ulëta të imunitetit në Evropë.\*\*\*\*
  - Kosova ka shkallën më të lartë të mortalitetit të foshnjave në Evropë, 27.8 në 1,000 lindje të gjalla, gjithashtu edhe shkallën më të lartë të lindshmërisë 22.1 në 1,000. Mirëpo, në Kosovë është vetëm 1 pediatër për 30,000 fëmijë nën moshën 5 vjeçare.\*\*\*\*\*
- \* "Kosovo Building Assessment." International Management Group, April 2000.
- \*\* "Kosovo: Reconstruction 2000" European Union/UNMIK Department of Reconstruction, April 2000 pp 63.
- \*\*\* World Health Organization Prishtina
- \*\*\*\* "Strengthening Epidemiological Services in Kosovo; A mid term Action Plan 1999 – 2002," World Health Organization.
- \*\*\*\*\* Helene Lefevre-Cholay, "Maternal, Child and Reproductive Health in Kosovo." World Health Organization, October 1999.

problem serioz gjatë dimrit. Kur një person është i sëmurë dhe nuk mund të ecë deri tek ambulanca më e afërt, ai person mund të vdesë.” Në Podujevë/o banorët brengosen për distancën në mes të fshatrave dhe shtëpive të shëndetit për arsye se “shumë njerëz nuk mund të arrijnë deri në spital për shkak të gjendjes së tyre të rëndë, kështu që duhet të mbeten të lëngojnë në shtëpi.” Ky mendim gjithashtu ekziston edhe në fshatin Magurë, ku një banor thotë se për një test të gjakut, fshatarët, shumica e të cilëve kanë probleme me transport, duhet të udhëtojnë dymbëdhjetë kilometra deri në Lipjan/Lipljan ose njëzet kilometra deri në Prishtinë/Pristina. Në Kamenicë/a banorët ankohen se mjeku vjen në shtëpi të shëndetit vetëm një herë në javë. Sëmundjet nuk ndodhin vetëm një herë në javë këtu, por çdo ditë,” derisa banorët e Skënderajt/Serbica shqetësohen se e vetmja qendër shëndetësore e cila gjendet në qytet dhe që i mbulon edhe 52 fshatra nuk është e pajisur që ti shërojë as rastet më të vogla traumatike.

Qasja ndaj shërbimeve shëndetësore në rajone me popullësi të ndara është gjithashtu shqetësuese. Një i moshuar në Mitrovicë/a thotë se “nga Mitrovica/a veriore më duhet të shkoj në anën jugore për të shkuar te mjeku. Unë jam i vjetër dhe është shumë me rëndësi për mua që të shkoj te mjeku rregullisht. Frikësohem se një ditë kur do të jetë ndonjë gjë më urgjente, ndihma do të jetë shumë larg.” Shpesh propozohet që të ndërtohen më tepër shtëpi shëndeti nëpër fshatra “në mënyrë që vetëm në rastet më serioze do të duhej që të udhëtohet për në qytet,” kështu që “çdo qytet do ta ketë spitalin e vet, dhe çdo fshat do ta ketë ambulancën e vet.” Ata gjithashtu kërkojnë që të kenë personel me orar të plotë, dhe në vend se mjeku të shkojë një apo dy herë në javë, ata propozojnë që mjekët dhe infermieret të shkojnë në fshatra më të vogla.

## Çmimi i trajtimit mjekësor

Çmimi i lartë i shërimit mjaft shpesh është shkaktar i zhgënjimit. Njerëzve ua merr mendja se atyre u mirren shuma marramendëse për barëra; disa përmendin korrupsionin dhe pyeten ndoshta personeli mjekësor i ngrit çmimet e barërave në mënyrë që ti plotosojnë të ardhurat e tyre të ulëta. Një burrë nga Podujeva/o vë në pah se “spitalet janë të stërbushura dhe ne duhet të presin në radhë me orë të tëra. Shumë prej tyre në fund i paguajnë çmimet e larta në ordinancat private të mjekëve sepse nuk mund të arrijnë në radhë gjatë orarit të tyre në spital.” Çmimet e larta dhe spitalet e stërbushura janë çështje të rëndësishme në shumë komuna. Një grup në Gjilan/Gnjilane përfundon se “shërbimi shëndetësor duhet të jetë falas për ata që nuk kanë mundësi të paguajnë,” derisa në Dragash/Dragas banorët thonë se shtëpitë e shëndetit rrallëherë i kanë barërat e duhura, mirëpo edhe kur i kanë ato janë tepër të shtrenjta.”

## Mjekësia preventive

Përkujdesja preventive shëndetësore është edhe një çështje që shumë mendojnë se ka prioritet të lartë. Kështu, ata dëshirojnë që të ngritets niveli i vaksinimit dhe një fushatë për ta ngritur nivelin e vetëdijes mbi çështjet shëndetësore. “Më tepër peshë duhet ti ipet preventimit dhe arsimit shëndetësor,” thotë një dermatolog nga Prishtina/Pristina, duke shtuar se, “liderët e ardhshëm komunal duhet të krijojnë fonde për trajtime preventive.” Një mësuese nga Prishtina/Pristina propozon “ndërtimin e institucioneve speciale për parandalimin e sëmundjeve dhe të shprehive negative siç është varësia ndaj drogës.”

## Shëndeti i gruas

Shëndeti i gruas është shpesh aktual, sidomos në rajone rurale. Një qytetare në Podujevo/ë thotë se, “gjendja nëpër fshatra është shumë e rëndë, sidomos për mungesë të arsimit mbi mjetet kontraceptive.” Femrat ndjejnë se mjekët nuk i marrin parasysh nevojat e tyre specifike shëndetësore. Ato gjithashtu thonë se në të kaluarën nuk ka pasur dialog të hapur për çështje të tilla siç është kontracepcioni apo shëndeti i gruas dhe atyre ua merr mendja se si rezultat i kësaj segmente të popullatës ngurojnë që të shkojnë për shërim të sëmundjeve të tyre apo të kërkojnë këshilla në lidhje me metoda kontraceptive. Një grup i femrave nga Prishtina/Pristina thonë se shumë mjekë nuk kanë njohuri të posaçme ose nuk janë të interesuar që të japin informata mbi shëndetin e gruas ndërkohë që qendrat për planifikim të familjes pothuajse nuk ekzistojnë nëpër fshatra dhe femrave tradicionalisht nuk u ka hije që të pyesin për këto gjëra.

Shqetësim tjetër është shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjave në Kosovë – vlerësuar nga WHO diku rreth 27.8 për qind në 1,000 lindje të gjalla – gjithashtu edhe shqetësimi se gratë shtatzëna nuk kanë trajtim sistematik para dhe pas shtatzënisë. Një avokat nga Podujeva/o shkruan se “Kosova ka një shkallë të lartë të lindshmërisë, mirëpo gjithashtu edhe një shkallë të lartë të mortalitetit të foshnjeve të posalindura, dhe për këtë arsye duhet të kemi kujdes të veçantë ndaj përkujdesit shëndetësor të nënave dhe fëmijëve.”

## Përfundim

Në përgjithësi mendohet se qasja ndaj shërbimit shëndetësor dhe rrjedhimisht, një shoqëri e shëndoshë është themeli thelbësor për mbi të cilin qëndron apo do të bie shoqëria kosovare. “Trupi i shëndoshë, mendja e shëndoshë” përsëritet shpesh, siç mendohet se mirëmbajtja e shëndetit është parakusht për një “shoqëri të mirë”. Në tërë Kosovën mendohet se zhvillimi i shoqërisë është ngusht i lidhur me shëndetin, dhe se liderët e ardhshëm komunal, në mënyrë që ta sigurojnë mirëqenien dhe përparimin e Kosovës, duhet të koncentrohen në përmirësimin e shëndetit të popullatës dhe të sistemit të mbrojtjes shëndetësore.

### Organizata botërore e shëndetësisë

Spital	Shtretër për spital	Shtretër për 1,000 banorë
Prishtinë/Pristina	2,377	4.1
Pejë/Pec	487	2.1
Gjakovë/Djakovica	523	2.1
Prizren	651	1.6
Gjilan/Gnjilane	488	1.6
Mitrovicë/Mitrovica	470	1.5

## 2. Arsimi

*Ku nuk ka shkolla, ka burgje.*

Mësuese, Podujeve/Podujevo

Arsimi konsiderohet si çështja më prioritare pas shëndetit. Në komentet e shkruara shpesh gjendet në fillim të listës, dhe gjithandej Kosovës insistohet se rëndësia thelbësore e arsimit nuk mund të jetë e tejtheksuar. Atje ku mbrojtja shëndetësore konsiderohet si parakusht për jetë njerëzore, arsimi konsiderohet jo vetëm si parakusht për zhvillimin e trurit të njeriut, mirëpo në të vërtetë si parakusht për zhvillimin e një shoqërie moderne, demokratike dhe të civilizuar. Njerëzit vazhdimisht e cekin ndërlidhmërinë e drejtpërdrejtë midis gjendjes në arsimin kosovar dhe shkallës së lartë të papunësisë, devijimeve dhe kriminalitetit në mesin e rinisë kosovare.

Rrjedhimisht, sa i përket arsimit, zëri i votuesve është i lartë, i qartë dhe i unik: Kosova duhet ti përkushtohet rindërtimit të saj, zgjerimit dhe modernizimit të sistemit shkollor në çdo nivel, prej atij parashkollor deri tek niveli universitar dhe më tej. Doemos duhet të rindërtohen shkollat e shkatërruara, të ndërtohen shkolla të reja, dhe të pajisen këto me pajime të domosdoshme për të sjuar ambient të përshtatshëm për mësim. Gjithashtu duhet të kihet parasysh që të gjithë të kenë qasje të lire nëpër shkolla dhe të stimulohen që të shkojnë në shkollë. Qytetarët theksojnë se standardi i arsimit duhet të ngritet në nivel të atij të Evropës perendimore, të përmirësohet puna e mësimeve, dhe të riformësohet, depolitizohet dhe të profesionalizohet planprogrami. Në përgjithësi, liderët e zgjedhur duhet të veprojnë duke u bazuar në mendimin se një shoqëri qëndron ose bie, zhvillohet ose shthuret varësisht nga aftësia dhe përkushtimi i popullit që ta arsimojë vetveten.

### **Ndërtimi dhe rindërtimi i shkollave dhe pajisjet shkollore**

Shumë veta mendojnë se ndërtimi dhe renovimi i shkollave dhe pajisjeve shkollore është prioritet urgjent. Në disa bashkësi rurale thuhet se “shkollat” nuk janë asgjë tjetër vetëm se tenda. Siç ishte vërejtur nga një person nga Gllgovci/Glogovac, kjo e vështirëson mbajtjen e mësimit kur është moti i mirë, deri sa e bën të pamundur mësimin gjatë dimrit. Në bashkësi tjera, duke përfshirë disa në Dragash/Drage, theksohet nevoja për të ndërtuar një objekt parashkollor. Të tjerët shpesh tregojnë se shumë fëmijë nuk mund ta vazhdojnë arsimin e mesëm për arsye se nuk ka mjaft vende nëpër

shkollat ekzistuese. Siç edhe u tha në një takim në Podujevë/o, stërmbushja është problem serioz: “dy shkollat fillore në qytet u shërbejnë diku rreth 4,000 dhe 5,000 nxënës,” ata thanë. “Në njërin prej shkollave numri arrin në 3,000, dhe nxënësit duhet ta vijnë në mësimin në tri ndërresa, kështu që tejnarkesa është e dukshme.

Kosovarët vazhdimisht flasin për mungesën e pajimeve dhe kushteve shkollore, sidomos kabineteve, mobileve, bibliotekave, laboratorëve shkencorë, kompjuterëve, dhe fushave sportive. Mungesa e ujit dhe e higjienës nëpër shkolla është gjithashtu problem serioz. Rëndësia e këtij lloji të kushteve shpesh lidhet me dëshirën për ta krijuar një proces arsimor më joshës dhe praktik, që mund të aplikohet në profesione të ardhme dhe të jetë më pak teorik dhe i mërziqshëm. Siç shkruan një punëtor nga Mitrovica/a, “Ka shumë fëmijë këtu. Ne si prindër dëshirojmë që fëmijët tonë ta mësojnë rëndësinë e njohurisë, dhe se ata duhet ta vijnë në mësimin sepse këto janë momente të cilat do ti përcjellin gjatë tërë jetës së tyre”.

## Administrimi, funksionimi dhe reformimi i sistemit arsimor

Nevoja që të reformohet sistemi arsimor ishte gjithashtu temë konsensusi në takime anembanë Kosovës, dhe se duhet të ngritet kapaciteti për arsimimin e të gjithë sektorëve të popullatës, dhe se administrata dhe planprogrami duhet tu përshtaten standardeve evropiane. Kur pyten se si duhet të bëhen këto përmirësime, disa, duke e përfshirë këtu një grup nga Podujevo/a, e theksojnë nevojën që prindërit dhe mësimdhënësit ti institucionalizojnë metodat e bashkëpunimit që të sigurohet se nevojat e nxënësve janë përmbushur. Të tjerë japin ide siq janë programet skëmbyese midis shkollave brenda dhe jashtë Kosovës. Më shumë së çfarëdo tjetër theksohet rëndësia që personeli të jetë mirë i stërvitur, profesional dhe të jetë i entuziazmuar për arsimim. Ngritja paralele e pagave dhe përgjegjesisë së punës për arsimtarët gjithashtu përmendet si metodë për ta arritur këtë.

“Të rriten rrogat e arsimtarëve,” thotë një grua nga Deçani/Decani, “është mënyra më e mirë që të stimulohen ata që të përkushtohen ndaj mësimin të fëmijëve.” Kjo nuk do të thotë se arsimtarët vetëm mendojnë për para, shton një njeri nga Peja/Pec: “E kam një shok i cili është arsimtar. Ai është i mençur, punëtor dhe i përkushtuar, mirëpo tashti ai është duke shitur fruta në rrugë për ta mbajtur familjen. Ai i don nxënësit dhe dëshiron ti mësojë ata mirë, mirëpo në këto kushte ai nuk mundet të përkushtohet në

### Të dhënat për arsimin

- Ekzistojnë 1,220 qendra arsimore në Kosovë [45 shkolla për infermierë, 1044 shkolla fillore, 97 shkolla të mesme, 10 shkolla të larta dhe 24 shkolla të larta pedagogjike], rreth 66% e të cilave ishin dëmtuar shumë nga lënia pas dore me vite ose nga konflikti i fundit kur u shkatërruan 5% prej tyre.\*
- Momentalisht vlerësohet se rreth 400,000 nxënës dhe studentë vijnë në mësimin në të gjitha nivelet arsimore, dhe 23,000 mësimdhënës.\*\* Kjo do të thotë se një mësimdhënës vie në çdo 17 nxënës në Kosovë, edhe pse raporti nxënës/arsimtar dallon prej shkolle në shkollë. Mirëpo, tani për tani, vetëm 86 % të nxënësve të moshës shkollore shkojnë në shkollë.\*\*\*
- Më 1981, shkalla e analfabetizimit në Kosovë ishte rreth 18% (9.4 për meshkuj, 26.4 për femra).\*\*\*\*
- Analfabetizimi në mesin e popullatës së tanishme më të moshuar se dhjetë vjet është 6%, (2% për meshkuj dhe 9% për femra).\*\*\*\*

\* “Kosovo Building Assessment.” International Management Group, April 2000.

\*\* UNMIK Department of Education

\*\*\* Kosovo Consolidated Budget 1 January- 31 December 2000.

\*\*\*\* “Kosovo-United Nations Partnership for a Human Development Strategy.” United Nations Development Group, November 17, 1999.

\*\*\*\*\* “Basic Results: Kosovo Demographic, Socio-economic and Reproductive Health Survey.” IOM, May 2000.



## Zëri i votuesve

tërësi ndaj profesionit të tij". Të tjerë në takim tregojnë se kjo është situatë tipike. "Pagesa më të larta arsimtarëve janë kyqe," pajtohet njëri nga Suhareka/Suva Reka, "mirëpo këto rritje dhe kontratat duhet të jenë të bazuara varësisht nga puna e tyre. Në këtë mënyrë, në mund ta ngrisim nivelin e mësimdhënies së tyre".

Kur ballafaqohen me nevojën që të marrin vendime të vështira, duke i pasur parasysh resurset e kufizuara dhe probleme të shumta për të shqyrtuar në bashkësi, njerëzit prapëseprapë insistojnë që arsimi duhet të jetë prioritet i lartë në mënyrë që bashkësitë e tyre të përparojnë. Sipas një ekonomisteje të Shoqatës së gruas të Gjakovës/Djakovica, "arsimi duhet të reformohet, dhe se na duhen arsimtarë të stërvitur mirë dhe profesional, kështu që ata edhe duhet të paguhën më mirë. Arsimi është investim afatgjatë mirëpo shpërblimi është i lartë." Për më tepër, "arsimi zgjidhë edhe probleme të tjera sociale, ekonomike, kulturore dhe është i domosdoshëm që shoqëria të funksionojë" thotë njëri nga Deçani/Decani. Sipas një grupi nga Ferizaj/Urosevac dhe Kaçaniku, "ekziston vetëm një mënyrë që të përparojmë, dhe kjo është arsimi".

Në anën tjetër, njerëzit i shohin shumë të meta nga mosarsimimi i rinisë së tyre si duhet: "Mungesa e arsimimit," thotë një grup tjetër në Glogovc/Glogovac, "e rrit papunësinë, krimin dhe dhunën." Duke e vazhduar këtë argument, një ingjener i bujqësisë nga Vitia/Vitina shkruan se "pa arsim, rinia do të mbetet e papunë, do të sillt rrugëve dhe do të bëjë vetëm gjëra të dëmshme për shoqërinë." Shumë thonë se pasoja të këtilla janë prezente qysh se tani: "Rinia po e braktisë arsimin," thotë një arsimtar nga Gjakova/Djakovica, "ata e zgjedhin rrugën e keqe në jetë duke menduar se ajo është rruga e drejtë. Numri i nxënësve në klasë është shumë i vogël".

Njerëzit gjithashtu e theksojnë nevojën për modernizimin, depolitizimin e planprogramit si dhe siç u tha më lart që ai të bëhet më praktik. Numri i lëndëve të ofruara duhet të rritet që të jipen më shumë zgjidhje dhe që të ketë më tepër mundësi për punësim të mëtutjeshëm. Më saktësisht, disa i përmendin kurset kompjuterike, mësim më intensiv të gjuhëve të huaja, administrim biznesi dhe mësim teknik. "Më tepër praktikë, më

### Analfabetizmi i popullatës mbi moshën 10 vjeçare

Analfabetët në zonat rurale	8%	Analfabetizmi sipas grupmoshave			
Analfabetët në zonat urbane	4%				
Analfabetizmi i femrave	9%				
Analfabetizmi i mashkujve	2%				
Analfabetë, përqindja femrat	83%				
		Moshat 10 – 29	6% analfabetë		
		Moshat 30 –59	1% analfabetë		
<b>Niveli më i lartë shkollor</b>	<b>Total</b>	<b>Pjesët urbane</b>	<b>Pjesët rurale</b>	<b>Pjesët me shumicë shqiptare</b>	<b>Pjesët me shumicë serbe</b>
Popullata 7 - 14 Vijojnë shkollën fillore	91 %	92 %	90 %	91%	85 %
Popullata 15 - 18 Vijojnë shkollën e mesme	70 %	82 %	58 %	70%	68 %
Popullata 19 - 28 Vijojnë shkollën e lartë	15 %	23 %	8 %	15%	10 %

"Basic Results: Kosovo Demographic, Socio-economic and Reproductive Health Survey." International Organization for Migration, May 2000.

pak teori," kërkon një grup nga Skënderaj/Serbica. Në Prizren një grup gazetarësh diskutonin se si mënjanimi i politikës partizane nga shkollat është jo vetëm element kyç për objektivitet në procesin mësimor, por është edhe thelbësor për zhvillimin e shoqërisë civile. "Tepër shpesh," thotë një gazetar, "arsimtarët e kanë keqpërdorur ndikimin dhe besimin në ta për tu shërbyer interesave të partive apo politikanëve. Kjo duhet të ndalet në mënyrë që arsimit të shkojë përpara." Pavarësia e arsimtarëve është edhe një brengë tjetër si dhe liria nga kërcënimi dhe mundësia për ta notuar një nxënës në mënyrë objektive dhe të drejtë. Përfundimisht, shpesh propozohet që sistemi arsimor i Kosovës të huazojë nga modelet e suksesshme në vende të tjera, për shembull nga Gjermania apo nga vende të tjera perendimore.

## **Mundësia për arsimim**

Edhe kur shkollat punojnë në rregull, paraqiten shqetësimet për grupet e injoruar me mundësi të kufizuar për arsimim. Për shembull pakicat. Shpesh kjo ka të bëjë me gjuhën; e drejta për përdorim zyrtar të gjuhës amë në shkolla me rëndësi të veçantë është për bashkësitë turke dhe boshnjake. Për shembull, një turk nga Prizreni thotë se "arsimimi është problem i madh për pakicat në Kosovë. Zgjidhje më e mirë për ne do të ishte që të zyrtarizohet gjuha turke." Të tjerë që ballafaqohen me resurse të kufizuara janë fëmijët në fshatra të izoluara dhe që nuk kanë transport adekuat deri te shkolla më e afërt. Fëmijë të tjerë nuk mund ta vijnë shkollën dhe detyrohen të punojnë pasi familja e tyre nuk ka kushte ekonomike të duhura. "Të gjithë fëmijët," thotë njëri nga Klina/a, "duhet ta mbarojnë së paku shkollën fillore."

Pas rishqyrtimit të të gjitha mbledhjeve të mbajtura rreth e për qark Kosovës, për femrat më së shpeshti thuhet se nuk kanë qasje të lirë ndaj arsimit. Edhe meshkujt edhe femrat e cekin nevojën që të përmirësohen mundësitë për arsimimin e gruas, dhe në vazhdim mundësinë e tyre për të kontribuar ndaj zhvillimit dhe progresit të Kosovës, me nevojë urgjente për emancipimin e femrës. Vlerat tradicionale, sipas pjesëmarrësve në takime, i kanë shtyrë familjet duke i përfshirë edhe të rinjtë që të heqin dorë nga shpresat dhe premtimet e një arsimimi cilësor. Kështu që thuhet se, liderët duhet ta ngrisin vetëdijen mbi rëndësinë e arsimit të të gjithë anëtarëve të bashkësisë. "Nuk do të ketë përparim pa arsimimin e femrave," shkruan një inxhinieri nga Prishtina/Pristina, e cila përfundon me këtë proverb: "Më jepni një nënë të arsimuar, dhe do t'ju jap një komb të shëndoshë."

## **Përfundim**

Arsimi nuk konsiderohet vetëm si mënyrë e bartjes së njohurisë dhe aftësive tek të rinjtë, sado thelbësore që është, mirëpo më tepër e ka rolin e një force civilizuese me fuqi për ta formuar ardhmërinë e një shoqërie. "Arsimi," thotë një biznesmen nga Istogu/Istok, "është hapi i parë drejt demokracisë dhe zhvillimit të shoqërisë." Në Klinë/a një tjetër shton se "arsimi më i mirë për fëmijët tanë mund ta ndihmojë integrimin e plotë të fëmijëve tanë në shoqëri." Një profesor i artit në Prishtinë/Pristina propozon se "me arsim mentalitete të ndryshme bëhen më të moderuara dhe se arsyeja fiton," dhe një educator parashkollor nga Prishtina/Pristina shkruan se "duke i pasur parasysh rrethanat e vështira në të cilat shkollat kanë punuar viteve të fundit, ne do të dëshironim që ky vit të jetë paqësor që mendja e fëmijëve tanë mos të jetë e dominuar nga situata politike, por nga një libër plot njohuri, mençuri dhe shpresë".

### **3. Zhvillimi ekonomik /punësimi**

*Mos na jepni peshqi, por na sjellni rrjetat.*

Suharekë/Suva Reka

Zhvillimi ekonomik dhe punësimi gjenden shumë lartë në listën e çështjeve më prioritare si dhe në listën e çështjeve më të përmendura. Me një shkallë të lartë të papunësisë dhe në një shkallë të ulët të zhvillimit të ekonomisë, situata ekonomie është kyçe ndaj së cilës njerëzit e planifikojnë ardhmërinë e tyre. Çështjet kryesore janë mungesa e vendeve të punës në Kosovë, që buron nga fakti se shumë resurse natyrore nuk shfrytëzohen dhe se fabrikat nuk punojnë me kapacitet të plotë. Privatizimi dhe mbledhja e tatimeve gjithashtu përmendeshin shpesh, siç është edhe nevoja për më shumë vende të punës për femra. Përmirësimi i klimës ekonomike në përgjithësi dhe rritja e punësisë në veçanti konsiderohen si zgjidhje e përgjithshme për shumë probleme në Kosovë, nga lehtësimi i tendosjes politike deri te zvogëlimi i krimit dhe përmirësimi i marrëdhënieve në mes grupeve etnike.

#### **Riaktivizimi i industrisë**

Çështja e fabrikave që nuk funksionojnë dhe të resurseve natyrore të pashfrytëzuara përmenden shpesh. Banorët e Kaçanikut thonë se “fabrikat në qytezën tonë dhe pothuajse në tërë Kosovën nuk funksionojnë, dhe kjo e keqëson papunësinë edhe më tepër.” Banorët e Karaçevës shtojnë se derisa ata i kanë dy miniera dhe ekspertë të mjaftueshëm për shfrytëzimin e këtyre, ata nuk kanë pajisje. “Nuk na duhen peshqit, ne sjellni rrjetat,” thotë një banor i Suharekës/Suva Reka. Banorët duan që liderët komunal ti kontaktojnë investitorët e huaj për të cilët mendojnë se mund ta përmirësojnë situatën e përgjithshme ekonomike dhe tu lejojnë kosovarëve që ti ndihmojnë vetëvetes me fillimin e punës në fabrika.

#### **Privatizimi dhe mbledhja e tatimeve**

Derisa disa persona dëshirojnë që të marrin më tepër ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare, shumë të tjerë mendojnë se privatizimi dhe joshja e investimeve të huaja janë kyçe për ekonomitë. Një turk nga Prizreni thotë “se është me rëndësi që të fillojë privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Vetëm atëherë do të mund ti joshim

investitorët e huaj," njëide që jehon nëpër të gjitha komunitetet në Kosovë. Gjithashtu besohet se rikonstruktimi i infrastrukturës dhe rivendosja e një sistemi bankar do të ishte shenjë pozitive për joshjen e investitorëve të huaj. Njerëzit shpesh kanë vizionin e punës së përbashkët me liderët e bashkësive për krijimin e një ambienti që do të joshte kapitalin nga jashtë. Koment tipik në Kaçanik është se "shoqëria duhet të punojë krah për krah me liderët komunal për të krijuar një atmosferë të sigurtë dhe stabile për investitorë potencial." Privatizimi, përmirësimi i infrastrukturës dhe krijimi i një ambienti të sigurtë brenda bashkësive janë parakusht për tërheqjen e investimeve nga jashtë.

Ndër zgjidhje të tjera të propozuara është mbledhja e tatimeve. Njerëzit me nervozitet e përcjellin sasinë e mallrave që lëvizin rreth e rrotull – pa u mbledhur tatimi – në "ekonominë ilegale të Kosovës". Ata dëshirojnë më shumë tatime në të mirat që shiten duke propozuar këtu mbledhjen e tatimeve nga "klubet e natës," birra e importuar dhe nga cigaret. Një person nga Ferizaj/Urosevac pyet se "pse disa blejnë qumësht nga Maqedonia kur Kosova ka prodhime qumështore të veta?" Ai, si shumë të tjerë dëshiron që njerëzit ta përkrahin ekonominë vendore, që të blejnë prodhime vendore dhe tu vënë tatim prodhimeve të huaja.

## Papunësia dhe krimi

Lidhja në mes të papunësisë dhe krimit diskutohet kudo në Kosovë. Njëri nga Urosevac/ Ferizaj thotë se nëse "mund të punësojmë më tepër, ata nuk do të kenë kohë që të kenë tendencë ndaj dhunës," derisa banorët e Malishevës/Malisevo brengosen se "gjithkund në Kosovë, papunësia krijon probleme të reja në shoqërinë tonë, duke përfshirë këtu drogën, prostitucionin dhe kriminalitetin". Ferizaj/Urosevac vëren se "të rinjtë mund të zgjedhin rrugë jomorale në jetë në qoftë se nuk kanë mundësi për tu punësuar," dhe një grup arsimtarësh nga Prishtina/Pristina pajtohen, duke pyetur se "pse të rinjtë sot të merren me arsim ose të punojnë kur e shohin se ka pak mundësi për punë të ndershme dhe shumë mundësi për të fituar para në mënyra të pandershme?"

Përmirësimi i ekonomisë konsiderohet si njëri prej faktorëve kyq për përmirësimin e jetës në Kosovë për këtë dhe për gjeneratën tjetër. "Fatkeqësisht një numër i madh i

## Të dhënat për zhvillimin ekonomik dhe punësimin

### Zhvillimi ekonomik

· Në dekadat e fundit, ekonomia e Kosovës ka qenë e përqendruar në nxjerrjen dhe prodhimin e lëndëve të para (70% të prodhimit të së përgjithshme kosovare konsiderohet se nxirret nga minierat e Trepçës), prodhimet gjysmë-finale (plumb, qymyr, zink) dhe nga bujqësia.\*

· Agjencia Evropiane për Rindërtim i ka ndarë në buxhet 35 milionë euro për investim në zhvillimin ekonomik të Kosovës në vitin 2000

### Employment

· Më 1987, PKB (produkti kombëtar bruto) i Kosovës ishte në nivel me Bregun e Fildishtë dhe Hondurasin.\*\* Më 1995, PKB i Kosovës ishte vlerësuar rreth 400 USD për person, dhe shkalla e papunësisë ishte 70%, derisa 53% të popullatës jetonin në varfëri.\*\*\*

· Sot, PKB vlerësohet të jetë paksa më i lartë, mirëpo Kosova akoma ka një shkallë të papunësisë 50%; 43% në rajone urbane dhe 57% në rajone rurale.\*\*\*\*

\* "Kosovo Within: Strategic Environmental Analysis of Albania, Bosnia & Herzegovina, Kosovo and Macedonia." The Regional Environmental Centre for Central and Eastern Europe, June 2000, pp 10.

\*\* Michel Roux, Les Albanain en Yougoslavie. Minorite nationale territoire et development. Paris: Editions de la Maison des Sciences de l'Homme.

\*\*\* "Towards Stability and Prosperity – A program for Reconstruction and Recovery" European Commission/ World Bank November 1999 pp 37.

\*\*\*\* "Basic Results: Kosovo Demographic, Socio-economic and Reproductive Health Survey." IOM, May 2000.

## Zëri i votuesve

---

njerëzve, sidomos të rinj, nuk punojnë asgjë,” thotë një mësues nga Podujeva/o, “mirëpo ata nuk kanë faj. Shkaku është mungesa e vendeve të punës.” Një studente nga Malisheva/Malisevo shton se ajo “do të dëshironte që të gjithë të jenë të punësuar dhe mos të bredhin rrugëve pa ndonjë cak” derisa një shtatëdhjetë e shtatë vjeçar nga Suhareka/Suva Reka vëren se “derisa gjenerata e re bredhë rrugëve, papunësia e shkakton krimin ndërkohë që edhe shturjet e tjera lëshojnë shtat.”

Mungesa e vendeve të punës është gjithashtu çështje prioritare për të gjithë pjesëmarrësit. Një ekonomist nga Mitrovica/a komenton se derisa kohët janë të vështira, papunësia po i vështirëson edhe më tej. “Shumë persona në Kosovë nuk kanë punë,” ai thotë, “dhe situata keqësohet edhe më tej”. Lidhur me këtë është problemi se shumë veta nuk mund të punojnë në profesionet e tyre. Një banor i Malishevës/Malisevo e shqipton zhgënjimin e tij ndaj situatës ekonomike, duke thënë se, “profesionet momentalisht janë në gjendje konfuzi: të huajt të cilët nuk dijnë asgjë për bashkësitë të cilave u shërbejnë janë policë, derisa policët tonë punojnë si mësues dhe arsimtarë, dhe arsimtarët tanë shesin fruta.”

## Gruaja dhe ekonomia e re

Femrat brengosen se nuk mund të gjejnë punë në strukturat e reja komunale, u shpreh një grua e papunë nga Istogu/Istok: “Dua që qeveria e re të jetë më përparimtare dhe të punësojë më tepër femra, jo si më parë kur ato ishin të diskriminuara në strukturat komunale.” Shumë femra mendojnë se pas luftës barra kryesore ekonomike bie mbi gruan. Një grua, të cilës tashti vonë i kishte vdekur burri dhe ajo vetëm duhet ta luajë rolin e kryefamiljarit tash e mbas, shton se “femrat nuk përfshihen në punë, e aq më pak pas luftës. Shumë gra i kanë humbur burrat dhe kujdesen për fëmijët e tyre, kështu që duhet të punojnë dhe duhet ta kenë një rrugë për të jetuar.” Derisa perspektiva ekonomike nuk është e mirë për shumë kosovarë, grate konsiderojnë se ato megjithatë kalojnë më së keqi.

## Përfundim

Funksionimi i mbarë i ekonomisë mendohet se është zgjidhja e shumë problemeve kosovare, dhe shpesh përmendet si faktor që do të “përmirësojë marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe serbëve,” “krijon kushtet për demokraci,” dhe ta përmirësojë cilësinë e jetës në përgjithësi. “Pa rritjen e punësimit,” shkruan një profesor nga Podujeva/o, “shoqëria do të stagnojë. Kjo do të sjellë dhunë dhe korrupsionim. Do ta ngrisë shkallën e krimit, do të sjellë kaosin e përgjithshëm dhe varfërinë. Kjo do ta ndajë shoqërinë në të pasur dhe në të varfër.” Njerëzit vazhdimisht i lidhin problemet e ndryshme në Kosovë me situatën ekonomike dhe e identifikojnë atë si katalizatorë që do ta shtyjnë popullatën drejt krimit dhe dhunës. Ndihmat e ndryshme humanitare nuk konsiderohen si zgjidhje. Njerëzit dëshirojnë punësim, dhe jo lëmshë, thotë një individ nga Gjakova/Djakovica. “Populli nuk duhet të jetë i varur nga ndihma humanitare gjatë tërë jetës” vazhdon ai, “ne duam të fillojmë të punojmë”. Përkundër mangësive në ekonomi, shumica e njerëzve janë optimistë për vendosmërinë dhe punën e popullit kosovar: “Çdo kosovar është biznesmen i lindur,” thotë njëri nga Suhareka/Suva Reka. Shumë të tjerë dëshmojnë se janë të gatshëm që të punojnë dhe dëshirojnë që liderët e ardhshëm tu ndihmojnë që ti rihapin dyert e punësimit dhe ti sjellin Kosovës ngritje ekonomike.

## 4. Uji

*Në fshatin tim ujit i vie era nga gypi edhe para se të arrijë .*

Një njeri nga rrethina e Ferizajt/Urosevac

I pyetur për ujin në bashkësinë e tij, një bujk nga Suhareka/Suva Reka përgjigjet thjesht: “Ujë?” Në të vërtetë, duke vlerësuar nga përgjigjet e njerëzve, gjendja është shumë serioze. Uji është prioriteti i katërt midis pesëmbëdhjetë çështjeve të paraqitura, dhe vie pas zhvillimit ekonomik dhe punësimit dhe para shërbimeve sociale, rrymës dhe strehimit. Në rajonet në të cilat problemet me ujin, cilësinë dhe furnizimin janë akute, kjo çështje shpesh kategorizohet si e para apo e dyta. Problemet më të shpeshta që raportohen janë mungesa e ujit dhe cilësia e dobët apo kontaminimi. Njerëzit shpesh janë saktësisht të përcaktuar kur është fjala për pasojat e kësaj gjendjeje në zhvillimin ekonomik, prodhimtarinë ushqimore, shëndet dhe në kushtet jetësore në përgjithësi që rezultojnë nga mungesa e ujit. Kur bisedohet për zgjidhjet e këtij problemi, shumë herë thuhet se ka ujë të mjaftueshëm të cilësisë së lartë; mirëpo rezervuari, gypat dhe sistemet e ujitjes janë dëmtuar, kurrë nuk janë përfunduar apo ende nuk janë ndërtuar.

### Uji dhe jeta e përditshme

Shqetësimi kryesor për shumë banorë është vështirësia e jetesës familjare prej dite në ditë pa furnizim adekuat me ujë të pastër. Një shitës nga Istogu/Istok, si shumë të tjerë, thotë se “nuk ka fare ujë të pijes, dhe se të gjitha pusët janë të ndotura.” Po këtë e thonë edhe banorët e Dragashit/ Dragash, se “uji nuk mund të përdoret për pije”. Në raportet nga një mbledhje në Karaçevë/Karecevo një person thotë sa i lumtur është që sistemi i ujësjellësit ishte zgjedhur si çështja më prioritare sepse kjo është çështja më

### Të dhënat për ujin

· Para vitit 1999, 64% të popullatës ka përdorur pusët si burim i vetëm i ujit, dhe vlerësohet kjo shifër të jetë e njëjtë edhe në vitin 2000.\* Derisa 50 % të popullatës, kryesisht në lagje urbane, kanë ujë nga instalime të ujësjellësit, vetëm 8.4% të banorëve në rajone rurale kanë qasje ndaj ujit të ujësjellësit. Rreth 85% të puseve private janë të kontaminuara.\*\* Diku rreth 35,000 puse janë pastruar dhe po mirëmbahen.\*\*\*

· Agjensia Evropiane për Rindërtim ka ndarë buxhet prej 10 milionë euro për investim në sistemin e ujësjellësit në Kosovë për vitin 2000.

\* World Health Organization

\*\* European Agency for Reconstruction

\*\*\* “Kosovo Within: Strategic Environmental Analysis of Albania, Bosnia & Herzegovina, Kosovo and Macedonia” The Regional Environmental Centre for Central and Eastern Europe, June 2000, pp 9.

## Zëri i votuesve

---

problematike në këtë fshat. 'Problemi më i madh', vazhdon ai, 'është mungesa e ujit të pijes; kjo është njëra prej arsyeve kryesore pse njerëzit e braktisin fshatin. Në Karaçevën e Epërme vetëm 10% të shtëpive nuk kanë probleme serioze me furnizim të ujit. Në një takim në Ferizaj/Urosevac, banorët tregojnë se si "puset në fshat janë duke u shterrur dhe në shumë raste janë ndotur që e bën furnizimin me ujë të pastër shumë të vështirë". Një burrë e përshkruan kështu gjendjen në fshatin e tij:

*Uji është problem serioz. Unë jam nga fshati Greme dhe në këtë fshat problemi i ujit është çështje jetike. Kohë më parë e nisëm një projekt për ta sjellur ujin nga mali, ta akumulojmë atë në një rezervuar uji dhe pastaj të distribuohet nëpër shtëpi, mirëpo nuk patëm sukses për shkak të çështjeve financiare kështu që mbetëm me puse të kontaminuara në fshatin tonë . . . dhe përsëri duhet ta marrim ujin prej puseve dhe ta vlojmë atë.*

Të tjerë e përshkruajnë problemin e fëmijëve sepse "disa shkolla në fshatra gjenden në rajone të largëta, kështu që, për shembull, atje ku shkollat gjenden lart në bjeshkë dhe nuk kanë ujë fëmijët duhet të sjellin ujë me vete në shkollë për çdo ditë". Në fshatin Varosh, "kushtet janë katastrofike," thotë një person. "Problemi kryesor në fshat është kanalizimi. "Më parë ne blenim pemë dhe perime atje, mirëpo tashti nuk blejmë më sepse kanalizimi depërton në to dhe ato kanë shije tepër të keqe."

## Higjiena, shëndeti dhe kontaminimi i ujit

Sëmundjet dhe shëndeti i lig janë shqetësime që më së shpeshti paraqiten së bashku me mungesën e ujit adekuat. "Pa ujë nuk ka shëndet apo higjienë," shkruan një edukatore parashkollore nga Prishtina/Pristina, "dhe ata që më së shumti vuajnë janë fëmijët të cilët sëmuren sepse nuk kanë mjaft ujë për pije." "Këtu në Malishevë/Malisevo," shkruan një infermiere, "të rriturit, dhe sidomos fëmijët, pijnë drejtpërdrejt nga lumi. Lumi është shumë i ndotur dhe mendohet se është i kontaminuar. Askush nuk e ka testuar ujin, mirëpo jam e sigurtë se mu ai është shkaktar i shumë sëmundjeve."

## Nevoja të tjera për ujë

Njerëzve u duhet uji i pastër për nevoja të ndryshme. "Uji është shumë i rëndësishëm për qeniet njerëzore," shkruan një inxhinier bujqësor nga Suhareka/Suva Reka, "mirëpo është gjithashtu i rëndësishëm për kafshë dhe për të mbjella," dhe, siç pajtohet kolegu i tij, "shumë i rëndësishëm edhe për bujqësi edhe për industri." Një pjesë e madhe e këtij takimi në Suharekë/Suva Reka iu kushtua bisedës për një sistem të ujitjes për rajonin i cili po të përfundohej do të përmirësonte jo vetëm kushtet jetësore për të gjithë banorët, por edhe kapacitetet prodhuese të këtij rajoni bujqësor. Të tjerë shpesh komentojnë pamundësinë që të jenë të pastër, ti lajnë enët dhe rrobet, apo që ti hedhin mbeturinat. "Uji është një çështje jetike," shkruan një qytetar nga Podujeva/o. "Duhet të ketë mjaft ujë për pije dhe për higjienë. Kjo çështje edhe është e ndërlikuar me kanalizimin dhe pastrimin e rajonit, që do të mbronte rrugët tona. Në përgjithësi uji do ta mbronte shëndetin." Për më tepër, një mendimtar nga Istogu/Istok thotë se, "Uji është burim jete dhe i ndërlikohet të gjitha format e jetës në një sistem jetësor në tokë".

## Zgjidhjet

Sa për atë se çfarë duhet bërë, njerëzit janë shpesh specifik dhe konkret. Një gazetar nga Prizreni thotë se mungesa e ujit nuk është problematike – ka mjaft ujë. Problemi është konstruktimi i një sistemi për bartjen e ujit atje ku ka nevojë për të. “Ne kemi mjaft burime të ujit këtu,” thotë ai. “Vetëm na duhet që të investojmë në shfrytëzimin e këtyre burimeve”. Për këtë arsye, në shumë bashkësi prioritet kryesor është konstruktimi ose përfundimi i sistemeve të tilla. “Të gjitha organizatat që punojnë në ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve duhet të ndihmohen,” shkruan një biznesmen nga Istogu/Istok. Bujqit e Suharekës/Suva Reka pohojnë se ndihma nga Banka Botërore do të ishte mënyra më efektive për përfundimin e sistemit të ujësjellësit dhe të ujitjes në rajon. Zotëriu i përmendur më lartë nga Karaçeva/Karecevo ishte mjaft specifik në këtë pikëpamje:

*Sikurse në Karaçevën e Epërme, zgjidhja këtu duhet të jetë që të sillen ekspertë për sisteme të ujit, të hulumtojnë dhe të gjejnë burime nëntokësore të ujit, dhe pastaj të gjenden donatorët të cilët mund të na ndihmojnë me pajisje: pompa uji dhe gypa. Na duhet pompa dhe një rezervoar që e mbulon tërë fshatin. Sa për Karaçevën e Ulët, kjo është çështje tjetër. Atje kemi mjaft ujë afër minierës. Mirëpo atje na duhet një rezervoar dhe pompa të reja të ujit për ti ndërruar ato të shkatërruara nga serbët. Këto pompa përdorëshin në minierë. Miniera do të kishte kapacitet që ta furnizojë Karaçevën e Ulët me ujë. Sasia e ujit është e mjaftueshme. Cilësia e ujit është shumë e mirë sipas analizave të bëra nga Instituti në Prishtinë.*

Përkundër tendencave të përgjithshme, shumë qytetarë nuk drejtojnë shikimin vetëm nga jashtë për zgjidhjen e problemeve. Siç vëren një burrë nga rrethina e Ferizajt/Urosevac, “unë mendoj se problemi kryesor është uji i pijes. Do ta zgjidhja këtë problem duke mbledhur para nga vetë banorët”. Në Viti/Vitina besohet se “resurset e ujit në komunë duhet të shfrytëzohen në mënyrë më racionale për ta përmirësuar situatën e tanishme. Pastaj, sistemi i ujësjellësit duhet të ndërtohet në fshatra dhe të mirëmbahet. Çfarëdo projekti që do ta përmirësonte cilësinë dhe sasinë e ujit duhet të ketë prioritet”. Gjithashtu propozohet një “fushatë për vetëdijësim të qytetarëve që të paguajnë për shërbimet publike duke përfshirë këtu edhe ujin. Këto fonde mund të përdoren për financimin e përmirësimeve në sistemin e ujësjellësit”. Në Gjakovë/Djakovica, një banor e përshkruan planin për progres: “Filloni ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për rajone rurale. Arsimeri njerëzit se si ta përdorin ujin racionalisht. Organizoni dhe mbledhni kontribute nga popullata për ndërtimin e këtyre sistemeve”.



## 5. Shërbimet Sociale

*Gjithë këto vite kemi dhënë një pjesë të rrogave tona për pensione dhe tashti ju prisni që ne të besojmë se thjesht nuk do të ketë pagesa? A mos vallë e gjithë kjo qe e kotë?*

Një banor nga Klina/a

Sigurimi social është çështje e rëndësishme në Kosovë, e pesta në mesin e pesëmbëdhjetë çështjeve, dhe njerëzit e dinë qartë se çfarë duan: rivendosja e sistemit pensional dhe e një sistemi të gjerë të ndihmës sociale. Mungesa e beneficioneve sociale ndaj popullatës së madhe të papunësuar – të vlerësuar në 50%<sup>1</sup> – është njëra prej brengave të shumta. Të vejat, bonjakët, dhe invalidët janë gjithashtu një grup i ndieshëm, të cilët siç thonë shumica kanë vështirësi të mëdha për të mbijetuar pa ndihma. Përfundimisht, janë të shumtë ata që shqetësohen për mospagesën e pensioneve pas aq vjetësh pune, dhe shumë qytetarë janë mbështetur në to për vitet e pleqësisë dhe sot ndjehen të humbur.

### Shqyrtimi i rasteve më të ndieshme

Një mjek nga Prishtina/Pristina e përthekon mendimin e shumë të tjerëve: “Kushtet e pensionistëve, të papunësuarve, grave, dhe fëmijëve janë afër një katastrofe humanitare. Përmirësimi i kushteve sociale duhet të ketë prioritet. Kur niveli i tyre të ngritet, atëherë edhe niveli i shëndetit dhe i arsimit do të ngritet. Përmirësimi duhet të inicohet me krijimin e fondeve nga qeveria për sigurim social. Çdo ndërmarje private që ka mundësi financiare duhet të parashohë një fond, dhe tatimet duhet të mblidhen nga ata dhe nga të punësuarit.”

Serioziteti i këtyre problemeve theksohet nga pjesëmarrësit gjithandej Kosovës. Për shembull, një qytetar i papunë nga Skenderaj/Srbica thotë, “Në dhjetë vjetër e fundit, mbi 80% të popullatës humbën vendet e punës. Sot, pas luftës, shtëpitë janë të djegura, grave u kanë vdekur burrat, fëmijët kanë mbetur pa prindër, dhe askush nuk merr ndihmë nga komuna, dhe si munden të kenë jetë normale?”

Një i papunësuar nga Gjilani/Gnjilane shton, “Ne duhet ti kushtojmë rëndësi çështjes së sigurimit social sepse kemi shumë njerëz që jetojnë në kushte shumë të këqija dhe

---

<sup>1</sup> “Basic Results: Kosovo Demographic, Socio-economic and Reproductive Health Survey,” International Organization for Migration, May 2000.

nuk kanë kurrfarë të ardhurash,” deri sa një ekonomist nga Vitia/Vitina propozon, “Rastet më të rënda si invalidët dhe gratë të cilave u kanë vdekur burrat, duhet të kihen parasysh. Së pari duhet ti vizitojmë, të flasim me ta dhe ti pyesim se çfarë nevoja kanë”.

Të vejat dhe nënat që vetë i rrisin fëmijët gjenden në pozitë të rëndë, pasi burimet e parave dhe mundësitë për punësim janë edhe më të vogla se sa për grupe të tjera dhe kjo do të thotë që ato janë shumë të varura nga sistemi i sigurimit social. Siç thotë një edukatore parashkollore nga Prishtina/Pristina, “Unë mendoj se shërbimet sociale janë shumë të rëndësishme sepse një numër i madh i burrave janë vrarë gjatë luftës dhe grave të tyre dhe fëmijëve u duhen të holla për të qenë të pavarur”. Një rrobaqepëse nga Prishtina/Pristina thotë, “Neve si nëna pa bashkëshortë na duhet më tepër kujdes dhe shërbime sociale sepse shumë prej nesh nuk kanë vendstrehim dhe na duhet përkrahje në rritjen e fëmijëve. Për shembull, mua më duhet të udhëtoj me vajzën time tërë kohën, sepse nuk kam ku ta lë”.

Njerëzit shpesh bisedojnë për ndihmat sociale të administruara nga Qendra për Punë Sociale, duke përfunduar se edhe ato nuk i mbulojnë nevojat e tyre, prapëseprap janë njëllor ndihme. Shpresa për ta zgjidhur këtë problem gjithashtu qëndron tek liderët komunal. Një person nga Malisheva/Malisevo thotë, “ne e kemi një numër të madh të individëve të traumatizuar, dhe ndihma që e marrin nuk u mjafton. Politikanët e ardhshëm duhet të mundohen që tu ndihmojnë këtyre njerëzve më tepër”. Një person i papunësuar nga Vitia/Vitina propozon “që të ndërtohen shtëpi speciale për të sëmurët mental të pastrehë,” derisa një propozim tjetër ishte që të hapen qendrat rehabilituese për “rastet sociale” nëpër Kosovë.

### Të dhënat për shërbimet sociale

Që nga shtatori i vitit 2000, ndihma sociale iu dha 37,000 familjeve me kushte të vështira nëpërmjet 27 Qendrave për Punë Sociale, që funksionojnë në 25 komuna. Duke u bazuar në kritere rigorozë, ndihmat ju dhanë familjeve që nuk kanë kurrfarë të ardhurash të tjera ndërkohë që askush në familje nuk ka mundësi të punojë. Në shtator apo tetor, departamenti planifikon që ta bëjë regjistrimin për “kategorinë e dytë” që janë familjet që kanë anëtarë që janë në gjendje të punojnë mirëpo megjithatë nuk e kanë askend të punësuar. Momentalisht nuk ka as pensione, as beneficione invalide apo fëmijërore dhe asnjëra prej tyre nuk pritet që të fillojë të shpërndahet së shpejti.\*

\* UNMIK Department of Health and Social Welfare

## Pensionet

Para luftës, shumica e popullatës ka paguar një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre në fondet jugosllave për pension. Si rezultat i zhvillimeve të fundit, pensionet nuk u paguhen individëve që përndryshe do të duhej të merrnin para. Kjo i ka sjellur shumë të moshuar në gjendje të vështirë pasi nuk i marrin të ardhurat në të cilat kanë llogaritur për pleqëri. Për këtë arsye, shumë prej tyre janë të shqetësuar. Siç thotë një qytetar nga Klina/a që do të duhej të dilte në pension, “Ne kemi punuar shumë për dyzet vjet, dhe tërë kohën e kemi dhënë një pjesë të rrogave tona për pensione dhe sot ju prisni që ne të besojmë se nuk do të ketë pagesa? A mos vallë gjithë kjo që e kotë?” Një mjek nga Prishtina/Pristina pajtohet duke thënë se “40% të rrogave tona janë shpenzuar për pensione dhe shërbime sociale dhe tani nuk e marrim asnjërin prej tyre. Kam qenë mjek për njëzet e tetë vjet dhe rrogën e kam 400 DM në muaj. Si mund të mendojë dikush për demokratizim kur nuk ka çfarë të hajë?” Kjo është çështje shumë brengosëse. Një teknik nga Gjilani/Gnjilane shton, “Ne kemi shumë njerëz që kanë

## **Zëri i votuesve**

---

nevojë për pensione. Ata kanë punuar gjatë tërë jetës së tyre në mënyrë që ta kenë një të ardhme dhe para të mjaftueshme për pleqëri. Ju lutemi të bëni diçka”.

## **Zgjidhjet**

Kërkesa për ta shqyrtuar mungesën e sigurimit social dhe të pensioneve është unike nëpër tërë Kosovën dhe paraqitet si çështje të cilën partitë politike duhet të bëjnë çmos që ta zgjidhin. Njerëzit e përkrahin rifillimin e mbledhjes së tatimeve për ta themeluar një fond për sigurim social, dhe për ti zgjeruar kriteret për ndihmë sociale. Ata duan që tu paguhen pensionet për të cilat kanë punuar vite të tëra dhe mendojnë se sistemet e gjithmbarshme sociale janë të domosdoshme që Kosova të eci përpara.

## 6. Rryma

*Ky problem na përket të gjithëve.*

Një shitës nga Malisheva/Malisevo

Rryma është problem i të gjithëve në Kosovë. Edhe pse kjo çështje radhitet e gjashta sipas prioritetit, do të thotë menjëherë pas sigurimit social dhe para strehimit, pothuajse askush nuk e vendosi në mesin e pesë çështjeve me më pak rëndësi. Njerëzit shfaqin gatishmëri për të treguar për problemet në lidhje me furnizim të dobët të rrymës dhe propozojnë zgjidhje, mirëpo mbizotëron një ndjenjë se këto probleme dhe zgjidhjet e tyre janë aq të dukshme dhe të njohura për të gjithë ashtuqë çfarëdo diskutimi i mëtejshëm është thuajse i tepërt. Problemi i rrymës ilustron shpeshherë kur në disa mbledhje të mbrëmjes të *Zërit të votuesve* papritmas ndalej rryma duke i lënë pjesëmarrësit që shqetësimet e tyre lidhur me rrymën ti shpalosin në terr. Njerëzit shpesh i ofrojnë dy argumente për të argumentuar pse furnizimi stabil me energji elektrike është esencial: së pari, konsiderohet si parakusht për jetë normale; së dyti, mendohet se është parakusht themelor për zhvillim ekonomik dhe investim nga jashtë. Për ta zgjidhur këtë problem, thuhet se duhet të bëhen investime të mëdha në mënyrë që të rifillohet puna në termocentrale dhe në sistemin e largpërcësuesve, të punësohen ekspertë për mirëmbajtjen e sistemit si duhet, dhe se banorët duhet ti paguajnë faturat për shfrytëzimin e rrymës.

### **Rryma dhe jeta e përditshme**

Pjesëmarrësit në takime shpesh flasin për problemet që kanë me furnizim të dobët të rrymës. “Këto ndërprerje të rrymës”, shkruan një ekonomist nga Gjakova/Djakovica, “sjellin probleme në shumë rajone, në shkolla dhe në familje. Po ta zgjidhnim këtë problem jeta jonë do të ishte shumë më e lehtë”. Shumë veta tregojnë se aktiviteti njerëzor është aq i varur nga rryma dhe pa të jeta është pothuajse e pamundur. “Pa rrymë”, thotë një burrë nga Podujeva/o, “nuk mund të hamë, të pijmë, të dëgjojmë apo të shohim. Kjo nuk është jetë. Rryma ka ndikim gjithkund, nuk mundesh as të mësosh pa rrymë elektrike e as të lexosh ndonjë gjë. . . . Duhet të paguhen llogaritë”. Në Dragash/Drage një inxhinier pajtohet se “Për shkak që kemi shumë probleme me rrymë, jeta normale është e paralizuar. Ne duhet të investojmë shumë në riparimin e elektranave”. Një i papunë nga Prishtina/Pristina thotë se “Kur nuk ka rrymë për tri apo katër ditë çdo gjë në frigorifer prishet dhe duhet të hidhet poshtë”. Në Malishevë/Malisevo njerëzit përmendin se si “rrjeti i rrymës është shumë i dëmtuar, sidomos në fshatra, kështu që rryma që e marrim mund të përdoret vetëm për dritë të dobët dhe për asgjë tjetër”. Shumë njerëz janë veçanërisht të brengosur për dimrin që afrohet.

### Të dhënat për rrymën

· Furnizimi i Kosovës me energji bëhet nga dy elektrana termike, Kosova A dhe Kosova B dhe hidrocentrale vendore. Para 1999, Kosova eksportonte 40% të rrymës që prodhonte në Bosnjë dhe Hercegovinë, ish-Jugosllavi, IRJ të Maqedonisë dhe në Greqi. Kosova tashti varet tepër nga rryma e importuar nga Bullgaria, Rumania, IRJ e Maqedonisë dhe ish-Jugosllavia.\*

· Pothuajse të gjitha shtëpitë në Kosovë janë të lidhura në rrjetin elektrik, mirëpo kërkesa e tejkalon ofertën.

· Për vitin 2000, Agjencia Evropiane për Rindërtim ka ndarë një buxhet prej 60 milionë euro për riparim të sektorit energjetik të Kosovës.

\* "Kosovo Building Assessment" International Management Group, April 2000

"Unë jetoj në një vend ku çdo gjë punon me rrymë", shkruan një grua nga Magura. "Nuk ka pajisje për ngrohje me dru, dhe tua them të drejtën nuk e di se si do ta kalojmë dimrin pa ushqim dhe pa nxemje". Një frizer i ri nga Prishtina/Pristina e ndan të njëjtën frikë: "Është shumë vështirë të përjetosh dimrin pa rrymë elektrike".

### Rryma elektrike dhe zhvillimi ekonomik

Njerëzit besojnë se furnizimi stabil me rrymë është kusht themelor për modernizimin e ekonomisë dhe për zhvillim. "Rryma shkakton probleme të mëdha sidomos në zhvillimin e ekonomisë shtetërore", shkruan një burrë nga Vitia/Vitina. Në Kodër të Diellit në Prishtinë/Pristina një agronom thotë "problemi i energjisë duhet të zgjidhet në mënyrë që të krijohet një ambient i tillë në të cilin të gjithë qytetarët do të mund tu përkushtohen profesioneve të tyre dhe ti kontribuojnë zhvillimit të shoqërisë sonë". Në Pejë një grup shpjegon se si fabrikat dhe industria në përgjithësi e kanë si parakusht furnizimin stabil të rrymës, mirëpo tani për tani, disa fabrika që mund të punësojnë një numër të madh të njerëzve në rajon mbeten jashtë funksionimit. "Superstruktura e një shoqërie, përfshirë këtu arsimin, shërbimet

sociale dhe kulturën rrjedhë dhe zhvillohet nga infrastruktura e saj", shpjegon një burrë nga ky grup, "dhe rryma është një përbërës thelbësor i kësaj infrastrukture". Në Suharekë/Suva Reka një grup thotë "Ne mezi po presim që të tërheqim investimet e huaja, por pa një furnizim adekuat me energji, kompanitë e huaja do të investojnë gjatë".

### Zgjidhjet

Shumë veta thonë se hapi i parë drejt përmirësimit të furnizimit me rrymë elektrike është që njerëzit ti paguajnë faturat e tyre. "Ndoshta", shkruan një grua nga Djakovica/Gjakova, "problemi do të zgjidhej po ti paguanim llogaritë me rregull". Një qytetar nga Ferizaj/Uroševac, njëlloj thotë se ai "do të dëshironte që kjo çështje të normalizohet, dhe që çdo shfrytëzues ta paguajë llogarinë e rrymës". Në Dragash/Drage një person pajtohet se "Të gjithë duhet ta paguajnë rrymën rregullisht", dhe shton se ata gjithashtu duhet ta "kursejnë rrymën në mënyrë që ta lehtësojnë situatën". Të tjerët propozojnë që pasi më të varfërit nuk kanë mjaft të holla që të paguajnë llogaritë e tyre, duhet të ndihmohen.

Shumica e njerëzve gjithashtu besojnë se duhen investime të mëdha për tu përmirësuar gjendja. Përfundimi i një grupi nga Ferizaj/Uroševac është ilustrimi i mendimit të shumë të tjerëve: "Ekspertët duhet të punojnë për ta përmirësuar situatën në elektranën e Obiliq/Obilic. Për ta arritur këtë duhen investime. Gjithashtu, rrjeti elektrik dhe transformatorët janë shumë të vjetër dhe të stërngarkuar, kështu që rrjeti duhet të riparohet dhe të sigurohen transformatorë të rinj". Porosi për udhëheqësit komunal, "zyrtarët e zgjedhur duhet të punësojnë ekspertë të cilët do të merren me këtë. Gjithashtu, ata duhet ta aprovojnë një ligj i cili do të vënte gjorbë secilit që nuk e paguan rrymën rregullisht. Poqese dëshirojmë të kemi rrymë të mjaftueshme, duhet që në mënyrë individuale apo kolektive ti paguajmë llogaritë e rrymës elektrike".

## 7. Banimi

*I shoh disa që jetojnë në tenda dhe siç afrohet dimri do të jetë shumë vështirë për këta njerëz dhe ata do të vuajnë shumë.*

Bujk, Viti/Vitina

Situata me strehimin në Kosovë i ka shtyrë shumë njerëz të mendojnë se çfarë do të bëhet me ta gjatë dimrit. Vlerësohet se rreth 36% të shtëpive të kosovarë ishin dëmtuar ose shkatërruar, një numër i madh i të cilave akoma nuk janë rindërtuar. Prandaj banimi mbetet lartë në listën e prioriteve. Posaçërisht është shqetësues se shumë njerëz ende nuk kanë gjetur zgjidhje tjetër përpos tendave ndërkohë që dimri po afrohet. Ata i kritikojnë kushtet jo të mira dhe shpesh jo të shëndosha në të cilat duhet të jetojnë pasi që nuk kanë shtëpi të tyre, vështirësitë e jetesës së familjeve të mëdha në një shtëpi të vogël, dhe shpejtësinë e ulët të rindërtimit deri më tash. Ata tregojnë se janë të gatshëm për ta filluar rindërtimin; mirëpo, shumicës prej tyre u mungon materiali ndërtimor ose paratë për ta blerë atë. Në përgjithësi, banimi konsiderohet si një e drejtë themelore që u mohohet atyre. Ata mendojnë se rindërtimi duhet të shpejtohet dhe se kjo është çështje në të cilën duhet të koncentrohen urgjentisht si bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe udhëheqësit komunal.

### Rindërtimi para dimrit

Në Deçan/Decani, rreth 65% të shtëpive janë fort të dëmtuara dhe të gjithë banorët e këtushëm njëzëshëm e ngritën çështjen e strehimit të jetë prioriteti më i lartë i tyre. Shumë shtëpi janë rindërtuar, mirëpo shumë banorë tregojnë se kundruall nivelit të shkatërrimit, banimi është akoma problem tepër i madh. Në një fshat, thotë një person, kanë mbetur 586 shtëpi për tu rindërtuar para dimrit. "Familjet më të varfëra jetojnë edhe më tutje nëpër tenda dhe nuk kanë mjete apo burra për ti rindërtuar shtëpitë", thotë një kimist nga Gllogovci. Komenti i tij, sikundër dhe i atyre nga shumë komuna të tjera, zbulon frikën e njerëzve se dimri do ti zë të papërgatitur. Një banore e Magurës poashtu shfaqë ndjenja të tilla: "Ne kemi mbi gjashtëdhjetë familje pa kulm mbi kokë," ajo thotë,

### Të dhënat për strehimin

· Anëmbanë Kosovës, 36% përqind të shtëpive kanë qenë të dëmtuara apo shkatërruara (120,000 shtëpi nga 333,000 sa është vlerësuar se janë gjithsej) në më shumë se 1,100 fshatra.\*

· Agjensioni Evropian për Rindërtim ka ndarë një buxhet prej 55 milionë euro për riparimin e shtëpive në vitin 2000.

\* UNHCR Pristina

“dhe dimri po afrohet. Diçka duhet të bëhet për ta”.

### Stërngarkimi

Shumë banorë janë të gatshëm që të marrin familje të tëra në shtëpitë e tyre, mirëpo kjo shpesh do të thotë edhe vështirësi të mëdha. Një person nga Klina/a e shpreh zhgënjimin e tij me këtë gjendje duke thënë, “Ka familje të mëdha me nga pesëmbëdhjetë apo njëzet anëtarë që jetojnë së bashku dhe nuk kanë para për ushqim apo për lëndë djegëse për tu ngrohur. Si mund të jenë ata të shëndoshë?” Ky problem ekziston në shumë komuna, shumë shtëpi janë përplot njerëz, mirëpo nuk ka zgjidhje tjetër. Një punëtor nga Mitrovica/a e përshkruan situatën: “Unë e kam një shtëpi shumë të vogël. Kur erdhi vëllau im e sollti edhe familjen e tij. Shtëpia e tyre ishte shkatërruar plotësisht, mirëpo shtëpia ime është tejet e vogël. Mijëra familje e kanë këtë problem. Çfarë mund të bëjmë?” Sikurse ky person, shumë të tjerë mendohen se çfarë duhet bërë. “Rindërtimi i shtëpive është gjithashtu mënyrë për rindërtimin e shoqërisë”, thotë një burrë nga Ferizaj/Urosevac. “Shumë bashkësi kanë fuqi pune të tepërt, mirëpo pak prej tyre kanë material apo të holla për ti ndërtuar shtëpitë nga e para. Një i papunë nga Lipjani/Lipljan thotë, “Ne kemi humbur njëzet e pesë njerëz të pafajshëm nga fshati ynë dhe 220 shtëpi janë djegur. Do të ishte rast shumë i mirë për banorët e këtij fshati për të qenë të përfshirë në rindërtim”.

### Rindërtimi i “egër”

Mungesa e rregulloreve për ndërtim dhe kaosi që pason është gjithashtu brengos një numër banorësh. Një banor nga Gjilani/Gnjilane thotë se rregulloret janë të domosdoshme për ta “parandaluar rindërtimin e egër”, deri sa banorët nga Prishtina/Pristina ankohen se rindërtimi i hovshëm po e humb çdo shenjë të planit urbanistik, “duke krijuar kaos dhe duke e shkatërruar infrastrukturën.” Një banor tjetër shton se ndërtimi pa leje shkakton shumë dëm, Prishtina/Pristina së shpejti do të “ngjajë një gërmadhe në të cilën do të jetë shumë vështirë të jetohet.”

### Përfundim

Reagimi i banorëve ndaj çështjes së banimit është mjaft i drejtpërdrejtë; ata janë të gatshëm që ta vazhdojnë rindërtimin dhe ta rivendosin një ndjenjë të normalizimit në Kosovë. Derisa disa drejtohen kah bashkësia ndërkombëtare për ndihmë, të tjerët dëshmojnë se nuk mungon fuqia punëtore, por materiali ndërtimor. Ata thonë se udhëheqësit komunal duhet të jenë aktiv në shqyrtimin e kësaj çështjeje, duhet ta rivendosin planin urbanistik si dhe të bëjnë çmos për tu siguruar të gjithëve kulm mbi kokë dhe ngrohtësi për dimrin që vjen. “Ne kërkojmë nga udhëheqësit politik tu ndihmojnë atyre që nuk kanë shtëpi,” thotë një person nga rrethina e Gjilanit/Gnjilane, “ti ndërtojë shtëpitë e tyre që ata të mund të kthehen”.

## 8. Rrugët

*Nuk ka nevojë tu tregojmë për rrugët. Ju nëpër to erdhët.*

Një burrë nga Klina/Klina

Nga çështjet e prezantuara, rrugët e zënë vendin e tetë. Shumë njerëz e shohin nevojën për një sistem rrugor më adekuat si një lëvizje të arsyeshme përpara. Kryesisht, mendohet se pa rrugë më të mira njerëzit nuk mund të udhëtojnë lehtë prej një vendi në vendin tjetër dhe nuk mund ti transportojnë mallrat e ndryshme, materialet apo resurset prej të cilave varet ekonomia. Shumë veta gjithashtu komentojnë problemet e mëdha në trafik

### **Rrugët dhe jeta e përditshme**

“Në Dragash/Dragas,” thotë një mësues, “lidhjet në mes të fshatrave janë shumë të këqija, dhe udhëtimi prej një fshati në tjetrin është shumë i vështirë. Gjithashtu, gjatë dimrit rrugët janë të bllokuara, dhe mbetemi të izoluar dhe të mbyllur. Ky është problem serioz kur ka urgjencë shëndetësore.” Një i papunë nga Gllogovci/Glogovac thotë: “Riparimi i rrugëve është shumë me rëndësi në rajonet rurale sepse disa pjesë janë të izoluar, sidomos gjatë dimrit. Rindërtimi i tyre duhet të financohet nga mbledhja e tatimeve nga ndërmarrjet private”. Kushtet e mjera të rrugëve shpesh janë temë kryesore: “Rruga në fshatin tim është e shkatërruar”, shkruan njëri nga Mitrovica/a, “dhe shpresoj so do të rindërtohet së shpejti”. Një teknik i makinerisë gjithashtu nga Mitrovica/e pajtohet dhe shton se: “Rrugët tona janë shumë të shkatërruara. Së pari duhet ti rindërtojmë dhe pastaj të ndërtojmë trotore dhe ndriçim elektrik. Kjo do ti parandalonte shumë fenomene negative”, siç janë aksidentet dhe krimi. Të tjerë shtojnë për problemin e trafikut rrugor. “Rrugët duhet të jenë prioritet i lartë sepse ato janë shumë të shkatërruara”, shkruan një instruktor nga Gjakova/Djakovica, “dhe ne kemi shumë probleme me trafikun”. Një numër i njerëzve tregojnë për rreziqet në trafik që vijnë nga gropat dhe nga rrugët e ngusta. Një ekonomist nga Vushtrria/Vucitrn shkruan se “Rrugët janë të shkatërruara, dhe shumë veta ngasin shumë shpejt,” dhe shton se, “ne duhet të mendojmë gjithashtu për gjelbrimin”.

### **Rrugët dhe zhvillimi ekonomik**

Një fjalë e shpeshtë është se “Pa rrugë të mira nuk ka zhvillim”. Në Istog/Istok një burrë thotë “Pa riparim të rrugëve, ekonomia e Kosovës nuk mund të përparojë”, dhe fqiu i



### Të dhënat për rrugët

- Kosova e ka një rrjet rrugor prej 3,800 kilometrash, përfshirë këtu 623 km rrugë kryesore dhe 1,300 km rrugë rajonale.\*
- Nga këto rrugë, rreth 6% janë në gjendje të mirë, 46% janë në gjendje mesatare, 29% janë në gjendje të keqe dhe 18% nuk janë të asfaltuara. Rrugët brenda qyteteve në përgjithësi janë në gjendje më të keqe për shkak të trafikut të dendur.\*\*
- Agjensia Evropiane për Rindërtim ka ndarë një buxhet prej 15 milionë euro për riparimin e rrugëve të Kosovës në vitin 2000.

\* "Kosovo Within: Strategic Environmental Analysis of Albania, Bosnia & Herzegovina, Kosovo and Macedonia." The Regional Environmental Centre for Central and Eastern Europe, June 2000, pp 14.

\*\* "Transport Damage Assessment." International Management Group, November 1999.

tij shton se "Pa zhvillim urbanistik, përfshirë këtu edhe rrugët, çdo vend është i prapambetur". Një grup nga Ferizaj/Urosevac pajtohet se "Rrugët ekzistuese duhet të rindërtohen dhe rrugët të reja të ndërtohen për ta përmirësuar komunikimin dhe këmbimin ekonomik midis komunave dhe fshatrave". Një gazetar nga Prizreni propozon se "Zhvillimi i infrastrukturës këtu në Prizren e ka si parakusht zhvillimin e lidhjeve të mira me komunat tjera. Rrugët duhet të jenë të të njëjtit standard si në Evropën Perëndimore."

### Zgjidhjet

Zgjidhjet e propozuara janë mjaft të thjeshta. "Për arsye se rrugët janë në gjendje shumë të keqe", propozon një grua nga Vitia/Vitina, "Unë mendoj se duhet të ndërtojmë rrugë të reja". Një njeri nga Dragashi/Drageas propozon "Të mblidhen kontribute vullnetare për ti rindërtuar rrugët", dhe në Ferizaj/Urosevac një grup njerëzish pajtohen që "çdo komunë të punësojë ekspertë të paanshëm cilët do të punojnë në projekte komunale rrugore". Një burrë i papunë nga Glogovci/Glogovac e ndan po këtë mendim dhe propozon që "rindërtimi i rrugëve duhet të financohet përmes vjeljes së tatimeve nga ndërmarrjet private". Të tjerë dëshirojnë që donatorët dhe anëtarët e bashkësive lokale të punojnë së bashku: "Donatorët," propozon një referent nga Istogu/Istok, "duhet të investojnë në riparimin e rrugëve dhe në të njëjtën kohë të punësojnë fuqinë punëtore nga këto fshatra".

## 9. Mbrojtja e ambientit

*Duhet të mendojmë gjithashtu për gjelbrimin.*

Ekonomist, Vushtrri/Vucitrn

Mbrojtja e ambientit është çështja e nëntë, jo vetëm si e tillë por edhe për rëndësinë e saj për shëndet. Fshatarët nga Malisheva/Malisevo i përmbledhin brengat e tyre duke thënë, “se mbrojtja e ambientit ndikon në mbrojtjen e shëndetit”. Çështjet kryesore që i shtrojnë njerëzit janë ndërlidhja e ambientit me shëndetin e popullatës, çështja e përgjegjësisë individuale dhe kolektive për mbrojtjen e tij si dhe dëshira për më tepër fushata publike mbi ngritjen e vetëdijes për ambientin dhe mbrojtjen e tij.

### **Shëndeti dhe ambienti**

Industria dhe minierat e Kosovës nuk kanë përcjellur standarde të larta për mbrojtjen e ambientit. Për shkak të kësaj, është shprehur shqetësimi për efektin që e ka ndotja në shëndetin e tyre. Në Mitrovicë/a brengosen për rreziqet potenciale që janë nga niveli i lartë i ndotjes. Një teknik i makinerisë nga pjesa jugore e Mitrovicës/a vëren se mbrojtja e ambientit “është shumë me rëndësi për ne sepse Mitrovica/a është shumë e ndotur. Na duhet ndihmë për ta parandaluar këtë katastrofë me përmasa të mëdha, ose do të kemi edhe më tepër sëmundje që do të na mundojnë”. “Ambienti është njëra prej çështjeve më të mëdha në fshatin tonë”, shton një student nga Magura, “sepse toka është shumë e ndotur dhe është shumë e rrezikshme për shëndetin tonë”.

Ekziston pajtueshmëri e gjërë në Kosovë se mbrojtja e ambientit është hap esencial drejt përmirësimit të situatës shëndetësore dhe se populli duhet të marrë masa më aktive drejt ruajtjes së ambientit. “Shkatërrimi i pasurive natyrore duhet të ndalet urgjentisht”, shkruan një grua nga Gjakova/Djakovica. Ndotja që prodhohet nga fabrikat kosovare shkakton shqetësim të madh. Një gjeolog nga Obliq/Obilic propozon “që të merren masa të përbashkëta me fabrikat relevante për ta zgjidhur këtë problem”, derisa një biznesmen nga Istogu/Istok thotë se “duhen të shpërndahen më tepër informata se si duhet të mbrohet ambienti”.

### Të dhënat mbi mbrojtjen e ambientit

· Kosova ka sipërfaqe prej rreth 11,000 kilometrash katrorë. 54% të tokës përdoret për prodhimtari bujqësore derisa 42% është e mbuluar me pyje.\*

· Kosova është një prej rejeve më të dendura në Evropë (210 banorë për kilometër katror), që i rëndon pasuritë natyre mjaft. Prerja e drujve nuk ka qenë e kontrolluar, dhe sipas Departamentit të ambientit 30% të pyjeve janë dëmtuar nga sëmundjet.\*\*

· Ndotësit kryesor të Kosovës vijnë nga aktivitetet e mëparshme në miniera, nga prodhimi i energjisë dhe nga trafiku i madh automobilistik, e gjithashtu edhe nga mbeturinat e ndryshme që e shkaktojnë ndotjen e tokës dhe të ujit. Ekzistojnë rreth 300,000 vetura në Kosovë dhe 100,000 prej tyre janë në Pristinë. Përveq sasisë së lartë të plumbit që vie nga benzina me plumb, mbeturinat që nuk mund të treten dhe që hidhen në burime kryesore të ujit dhe shpërhapja e parregulluar nga fabrikat i kanë kontribuar nivelit të lartë të ndotjes në Kosovë.

\* "Kosovo -United Nations Partnership for a Human Development Strategy." United Nations Development Group, November 17, 1999.

\*\* "Kosovo Within: Strategic Environmental Analysis of Albania, Bosnia & Herzegovina, Kosovo and Macedonia" The Regional Environmental Centre for Central and Eastern Europe, June 2000.

### Marrja e përgjegjesisë

Një grup në Kaçanik beson se "komunitetet duhet të punojnë së bashku me qeveritë lokale për ta mbrojtur ambientin nga ndotja dhe ti përkrahin ligjet që e ndalin ndotjen", derisa një student në Magurë shton se "ne duhet të ndërmarrim aksione konkrete për ta mbrojtur ambientin, duke filluar prej fshatit dhe komunës". Mbrojtja e ambientit radhitet më së larti në Ferizaj/Urosevac, Kamenicë/Kamenica dhe Prishtinë/Pristina ku përkundër problemeve tjera akute, njerëzit janë të vendosur për "mbjelljen e drunjve në qytete dhe në kodra", "mbrojtjen e pyjeve dhe lumenjve" dhe "për krijimin e më shumë vendeve të gjelbruara". Njerëzit në gjithë Kosovën pajtohen se derisa ka shumë probleme akute, ata gjithashtu duhet ta pranojnë një shkallë të përgjegjesisë personale dhe ti shtyejnë fabrikat që ta pranojnë përgjegjësinë e tyre për ambientin.

## 10. Mbeturinat

*Ne duhet vetë të organizohemi që ti mbledhim mbeturinat dhe ta mbrojmë ambientin ku jetojmë.*

Një grua nga Prishtina/Pristina

Mbledhja e mbeturinave është prioriteti i dhjetë. Mirëpo, një numër tejet i madh i komenteve të shkruara kanë të bëjnë me këtë problem. Problemi kyç është përdorimi i mjedisit jetësor si deponi për mbeturina, mungesa e deponive dhe të mundësive për reciklim, rreziqet për shëndetin dhe për higjienën, mungesa e vetëdijes për ambientin dhe për dëmtimin e vet natyrës.

### **Hudhja e mbeturinave**

Është krijuar përshtypja se njerëzit i hudhin mbeturinat kudo që mundën, dhe kjo shpesh është rrjedhim i mungesës së deponive. Një biznesmen nga Istogu/Istok shkruan, "Mbeturinat duhet të mblidhen. Njerëzit e hudhin bërlllokun e tyre kudo sepse askush nuk e mblodh atë". Fqiu i tij pajtohet se "kjo çështje është shumë e rëndësishme sepse njerëzit i hudhin mbeturinat e tyre para dyerve të tyre ose në vende të tjera të papërshtatshme, dhe e tërë kjo ndodh sepse nuk ka transport". Për disa të tjerë ky problem është aq i madh sa që ndihen si të paralizuar. Në Gjakovë/Djakovica një grua thotë , "Më shqetëson kjo kur eci rrugëve dhe ndeshem me bërlllok tërë kohën dhe asgjë nuk ndërmirret lidhur me këtë".

### **Mbeturinat dhe shëndeti publik**

Shumë persona kanë shprehur shqetësim për rreziqet që mbeturinat paraqesin për shëndetin. "Në fshatin tim" shpjegon një burrë nga Mitrovica/a, "Ne kemi problem me mbeturinat dhe frikësohemi nga sëmundjet. Shpresoj se çdonjëri do të bëjë diç për këtë çështje dhe se do ta zgjidhim problemin". Një student nga Istogu/Istok pajtohet se "Në qoftë se bërllloku nuk grumbullohet mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme të cilat mund të jenë edhe vdekjepruese". Gjithashtu, një person nga Gllogovci/Glogovac beson se "Mbledhja e mbeturinave është çështje vërtet e rëndësishme. Shumica e popullatës i hudh mbeturinat në vende të papërshtatshme, që sjellin sëmundje të ndryshme, kështu që mund të apelojmë tek të gjithë që të mos hudhin mbeturina

## Zëri i votuesve

---

kudo". Kështu që, shkruan një person nga Gjakova/Djakovica, "Ne mund ta mirëmbajmë shëndetin dhe higjienën vet në qoftë se e mbledhim bërlllokun rregullisht". Shumë janë të shqetësuar me lloje të mbeturinave që janë të rrezikshme. Në Podujevë/ o shkruan një njeri, "Unë jam i brengosur me faktin se jetojmë në vendin më të ndotur. Ne jemi të ndotur jo vetëm nga mbeturinat ditore, mirëpo edhe nga mbeturinat nga lufta, nga mbeturinat e rrezikshme siç janë copa municioni, projekte dhe raketa, mina dhe kështu me radhë".

## Zgjidhjet

Njerëzit ofrojnë një numër të zgjidhjeve, duke përfshirë përmirësim në mbledhjen e mbeturinave, deponitë adekuate, reciklimin dhe fushatë të intensifikuara për vetëdijësim. "Siç e dijmë", shkruan një person nga Rahoveci/Orahovac, "problemi i mbeturinave në Kosovë është shumë i madh. Ne duhet ta ndërrojmë strategjinë sepse është shumë e rëndësishme për ne që ta ruajmë shëndetin tonë. Ne duhet ti arsimojmë të gjithë për këtë çështje". Një grua nga Prishtina/Pristina propozon, "Ne duhet vetë të organizohemi ta mbledhim bërlllokun dhe ta mbrojmë ambientin në të cilin jetojmë". Një edukatore nga Gjakova/Djakovica thotë se "mbeturinat duhet të mbledhen, dhe për këtë na duhen mjete transportimi për bërlllok", dhe një person nga Prizreni propozon se "mbeturinat duhet të grumbullohen në një vend special, jo vetëm në komunën tonë por edhe në komunat e tjera. Ne duhet të krijojmë deponi për këtë". Sipas një femre në Malishevë/Malisevo, "Jeta në ambient të shëndetshëm është kusht i domosdoshëm për të gjithë në këtë planet, dhe mbledhja e mbeturinave në mënyrë të organizuar dhe reciklimi i tyre do të ishte një hap në drejtim të mbarë". Një bujk nga Suhareka/Suva Reka përfundon se "Ne duhet të përkujdesemi për këtë se jeta do të na bëhet e tmerrshme".

### Të dhënat për mbledhjen e mbeturinave

40% të popullatës ka qasje ndaj shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave.\*

\* "Kosovo: Reconstruction 2000" European Union/UNMIK Department of Reconstruction, April 2000 pp. 114.

# 11. Kanalizimi

*Më parë blenim pemë dhe perime prej fshatit tonë por tani nuk blejmë më sepse kanalizimi depërton në to dhe tashti kanë shije tepër të keqe.*

Një banor i Ferizajt/Urosevac

Kanalizimi është prioriteti i njëmbëdhjetë sipas pjesëmarrësve të takimeve dhe ata e konsiderojnë kanalizimin si rrezik ndaj shëndetit të tyre por edhe ndaj ambientit ndërkohë që duan metoda të reja për kanalizim dhe ndërtimin e qendrave për trajtim.

Një nxënës nga Magura thotë se “kanalizimi i fshatit kalon afër dritareve të shkollës, dhe frigohe mi për ndojnë infektim”, derisa një banor i komunës së Kamenicës/a thotë “Unë e di se kanalizimi është i dëmshëm për shëndetin tonë, dhe se moti pa të reshura e bën erën e tmerrshme”. Të tjerët vërejnë se kanalizimi nuk është vetëm i rrezikshëm ndaj shëndetit por edhe ndaj ambientit. Banorët e Vitisë/Vitina ankohen se kanalizimi i fshatrave derdhet në lumin Morava. “Kjo e shkatërron ambientin”, thonë ata, dhe ata dëshirojnë që të ketë metoda më të reja për mënjanimin e fekalieve se sa hudhja e e tyre në lumin më të afërt. Në fshatrat Dubravë dhe Saradran në Istog/Istok banorët janë mjaft të shqetësuar për këtë çështje dhe dëshirojnë që popullata të jetë e “kujdesshme për eliminimin e fekalieve në fshatra në mënyrë që të parandalojë infeksione të ndryshme”.

## Të dhëna për kanalizimin

- Rreth 24 – 30 % të popullatës së gjithmbarshme të Kosovës, kryesisht në rajone urbane kanë qasje ndaj sistemit të kanalizimit. Shumica e sistemeve të kanalizimit janë në gjendje tepër të keqe dhe rreth 20 – 30% të sistemeve të kanalizimit kanë nevojë urgjente për riparim.\*
- Në tërë Kosovën, rreth 30% të ujit të kanalizimit deponohet direkt në lumenjtë kryesor. Pjesa tjetër ose absorbohet direkt në tokë, apo depërton deri tek uji i pijshëm ose në mënyrë indirekte përfundon në lumenjtë kryesor.\* Askund në Kosovë ky ujë i ndotur nuk trajtohet.
- Nga rreth 2,300 fshatra në Kosovë, vetëm 7% të popullatës rurale ka qasje tek sistemi i kanalizimit, derisa të tjerët mbështeten në gropa septike.\* Vetëm 32% të popullatës së Kosovës kanë qasje tek nevojtoret me kazan uji.

\* “Sanitation Damage Assessment” International Management Group, October 1999

## 12. Mbrojtja e pakicave

*Kur mbrojmë të tjerët me përkushtim , atëherë e mbrojmë edhe vetveten.*

Një bujk nga Suhareka/Suva Reka

Mbrojtja e pakicave është prioriteti i dymbëdhjetë në mesin e pesëmbëdhjetë çështjeve. Gjithashtu duhet të mirret parasysh se një numër i pjesëmarrësve nuk e kishin të qartë se si duhet të shqyrtohet kjo çështje: ata besojnë se kjo çështje është me rëndësi, mirëpo thonin se nuk ka pakica në bashkësinë e tyre ose në krahasim me bashkësitë tjera popullata pakicë jeton në siguri të mjaftueshme. Pasi që të gjithë pjesëmarrësit luteshin që të përqëndrohen në komunën e tyre sesa në situatën në Kosovë në përgjithësi, kjo pikë duhet të konsiderohet me kujdes kur vlerësohen rezultatet. Kur çështja diskutohet ose prezantohet me shkrim, njerëzit shpesh flasin me ndjenja apo oratori për nevojën që të mbrohen dhe të respektohen të gjithë njerëzit në Kosovë. Përfundimisht, ky përgjithësim nuk i përfshin edhe pikëpamjet dhe komentet specifike të bëra nga bashkësitë serbe që morën pjesë në këtë projekt. Ato janë paraqitur në aneks të veçantë.

Diskutimet dhe komentet për mbrojtjen e pakicave në përgjithësi e theksojnë përgjegjësinë morale dhe etike të të gjithë anëtarëve të një shoqërie që ti mbrojnë të drejtat dhe sigurinë e çdonjërit, e sidomos të atyre që janë të rrezikuar. Disa, përfshirë këtu edhe një burrë nga Vitia/Vitina, shprehin besim të madh se situata do të përmirësohet: “Ne njihemi si njerëz të qetë”, shkruan ai, “dhe prandaj besoj se ne do ti mbrojmë dhe do ti respektojmë të drejtat e të tjerëve”. Shumë qytetarë e identifikojnë lirinë dhe sigurinë e secilit si parakusht për zhvillimin e një shoqërie demokratike. “Të gjithë duhet të jetojnë në liri”, shkruan një person nga Malisheva/Malisevo, “dhe vetëm kështu mund ta kemi një shtet demokratik”. Një person tjetër nga Istogu/Istok beson se Kosova mund ta fitojë shtetin “vetëm në qoftë se pakicat që jetojnë aty respektohen. Kosova duhet të jetë multietnike”. Një infermiere nga Prishtina/Pristina shkruan “Ne duhet të kemi tolerancë dhe mirëkuptim për një jetë demokratike”.

Një numër i njerëzve ndihen emocionalisht të shpenzuar nga shumë vite të urrejtjes dhe dhunës së përjetuar dhe e shprehin dëshirën për të ikur nga tragjeditë e kaluara dhe për të përqafuar idenë që të gjithë njerëzit të jetojnë në liri dhe siguri. “Pas të gjitha këtyre gjërave që i ndodhën secilit”, shkruan një person nga Istogu/Istok, “të gjithë duhet ti kemi të njëjtat të drejta”. “Pakicat duhet të jenë të mbrojtura kudo që

janë”, shton një ekonomist nga po ky qytet. Një gazetar nga Prishtina/Pristina shkruan “Duhet të krijohen rrethana të tilla që askush mos të ndihet i lënë anash vetëm pse i përket një pakice kombëtare”.

Vlerësimet e populates	Sipas regjistrimit jugosllav të vitit 1991	Vlerësimi i UNHCR/OSBE Nëntor 1999 – Janar 2000
Shqiptarë*	1,596,072	-----
Serbë	195,301	100,000
Kroatë	8,161	500
Boshnjakë (Sllavë muslimanë)	57,408	35,000
Turq***	10,833	20,000 - 35000
Malazezë	20,045	-----
Romë**	45,745	30,000 magjypë, hashkalinjë dhe egjiptas
Egjiptas	5,984	-----
Goranë	12,000 – 15,000	-----
Të tjerë	3,444	-----

\* Një numër i shqiptarëve e bojkotuan regjistrimin jugosllav të vitit 1991.

\*\* Ky numër mendohet se është tejet i ulët. Paul Polansky e ka dhënë një numër më të besueshën sipas të cilit vlerësohet se më 1998 ekzistonin afër 150.000 magjypë, hashkalinjë dhe egjiptas në Kosovë.

\*\*\* Gjithashtu mendohet se është tepër i ulët. Një vlerësim më i përafërt për vitin 1991 do të ishte 20,000 - 40,000 turq

### Statistika e popullatës

· Sipas regjistrimit jugosllav të vitit 1991, në Kosovë kanë jetuar 195,301 serbë, 10,833 turq dhe rreth 45.000 “romë” (magjypë, hashkalinjë, dhe egjiptas), edhe pse vlerësohet se ky numër është tejet i ulët. Vlerësohet se në vitin 1998 në Kosovë ishin diku rreth 20.000 – 40.000 turq dhe deri 150,000 magjypë, hashkalinjë dhe egjiptas.

· Sot, vlerësohet se janë rreth 30.000 “romë” që kanë mbetur në Kosovë. Pakicat tjera në Kosovë vlerësohet të jenë rreth 100.000 serbë, 35.000 boshnjakë dhe torbeshë, 20.000-35.000 turq, 12.000 – 15.000 goranë dhe 500 kroatë.\*

\* OSCE/UNHCR Assessment Nov. 1999 – Jan., 2000



## 13. Telekomunikimi dhe posta

*Jemi larg nga Gnjilane/Gjilani dhe Kamenica/a, mirëpo me rivendosjen e një sistemi të telekomunikimit dhe një sistemi postar, në mund të jemi më afër botës së civilizuar.*

Banor, Karaçevë, Kamenicë/a

Mungesa e lidhjeve telefonike dhe e funksionimit të gjërë të shërbimit postar në Kosovë i shqetëson shumë qytetarë që e shohin postën dhe telekomunikimin si mënyrë të dorës së parë për të mbajtur kontaktin midis fshatrave dhe me pjesën tjetër të botës. Edhe pse gjendet në vendin e trembëdhjetë të prioritetit, kjo çështje ka rëndësi të veçantë për ata që jetojnë nëpër fshatrat më të izoluara.

### Mirëmbajtja e komunikimit brenda Kosovës

Në Istog/Istok një fshatar e zuri në gojë largësinë që duhet ta kalojnë disa njerëz për të bërë një telefonatë " Ne jemi katër kilometra jashtë qytetit dhe ne do të dëshironim të kemi telefona në fshatin tonë." Banorët e Rahovecit/Orahovac dëshirojnë të rivendosin

#### Të dhënat për telekomunikimin dhe postën

- Prej 130 postave në Kosovë, 91 funksionojnë. Pullat postare në vlerë prej 0.20-2 DM mund të blihen për dërgesa brenda apo jashtë Kosovës.\*
- Para luftës, Kosova kishte shkallën e dytë nga fundi për kah numri i telefonave për banor në Evropë me një mesatare prej gjashtë linjash në 100 banorë.\*\*
- Sot gjithandej Kosovës janë 120,000 të parapagues të linjave fikse,\* që do të thotë rreth gjashtëmbëdhjetë linja në 100 banorë.
- Gjashtë milionë euro janë ndarë për riparimin e sistemit postar dhe të telekomunikimit, përfshirë këtu 2 milionë për sistemin postar dhe 6 milionë për shërbimet e telekomunikimit.

\* UNMIK Department of Post and Telecommunications

\*\* "Kosovo: Reconstruction 2000" European Union/UNMIK Department of

linjat me botën e jashtme dhe në këtë mënyrë të kontaktojnë me kushërinjtë, kurse një banor i komunës së Istogut/Istok thotë, "kemi nevojë për rrjetin telefonik nëpër fshatra, ashtu që të mund të komunikojmë me botën."

### Të rinjtë dhe telekomunikimi

Rëndësia e rivendosjes së një sistemi telekomunikimi të rregullt gjithashtu theksohet nga grupe të rinjesh të cilët duan të kenë lidhje me internet. Një i ri nga Tryeza e Rrumbullakët Rinore nga Kamenica/a shkruan, "Vendosja e telekomunikimit për mua është çështje e tretë sipas rëndësisë sepse atëherë mund të zhvillohemi duke pasur lidhje me internet", derisa një pjesëmarrës tjetër beson se "sa i përket telekomunikimit, i vetmi problem tash për tash është interneti". Një i ri tjetër nga Istogu/Istok në mënyrë ironike vëren se do të ishte mirë që të kemi telefona statik përsëri pasi "u lodhëm nga njerëzit me telefona mobil!"

## 14. Aktivitetet kulturore

*Duhet tu kushtojmë rëndësi të veçantë aktiviteteve kulturore nisur nga nevoja për relaksim fizik dhe mental pas gjithë asaj që ka përjetuara populli i Kosovës.*

Një profesor nga Prishtina/Pristina

Duket se aktivitetet kulturore zunë vendin e katërbëdhjetë për arsyë të urgjencës së shumë çështjeve të tjera konkrete. Megjithatë, shumë veta mendojnë që kjo çështje është mjaft e rëndësishme sa të jetë midis tri çështjeve “më të rëndësishme”. Në përgjithësi, ata sugjerojnë se një theksim më i madh i aktiviteteve kulturore është i brendaqenësishëm për zhvillimin e një shoqërie ndërkohë që ato do të kishin një efekt relaksues dhe terapeutik tek ata që kanë vuajtur gjithë këto vite e të mos flasim për ndikimin pozitiv tek rinia e paretatshme.

### **Përparimi i kulturës**

Shpesh theksohet rëndësia e aktiviteteve kulturore për përparimin e shoqërisë kosovare. “Kultura është mbi të gjitha”, shkruan një elektro-inxhinier nga Prishtina/Prishtina, “kështu mosaktiviteti kulturor do të sjellë deri te ngecje në shumë fusha, përfshirë shëndetin dhe gjendjen e mirë (formën)sportive.” Një grua nga Peja/Pec pajtohet, “Kemi nevojë për zhvillim kulturor autentik”. Sipas një burri nga Prizreni, “nuk ka pasur mjaft shoqata sportive apo grupe valltarësh, mirëpo sot duhet të jemi të hapur ndaj aktiviteteve për relaksim fizik dhe mental”. Në këtë frymë shkruan edhe një profesor nga Prishtina/Pristina “Duhet tu kushtojmë rëndësi të veçantë aktiviteteve kulturore nisur nga nevoja për relaksim fizik dhe mental pas gjithë asaj që ka përjetuara populli i Kosovës”.

### **Aktivitetet kulturore dhe rinia**

Shpesh thuhet se të rinjve u duhen më tepër objekte plotësuese kulturore dhe aktivitete kulturore në të cilat mund të angazhohen. “Gjatë dhjetë viteve të fundit” shkruan një qytetar nga Mitrovica/a, “kjo çështje nuk ka pasur rëndësi të madhe, dhe pikërisht për këtë arsye duhet ti kushtojmë më tepër rëndësi tashti. Rinisë sonë i duhen aktivitetet kulturore dhe një vend ku mund ti ushtrojë ato”. Një biolog gjithashtu propozon “më tepër vende në të cilat rinia mund tu përkushtohet aktiviteteve të veta, siç janë për shembull palestrat sportive”. Një agronom nga Suhareka/Suva Reka gjithashtu shkruan, “na duhen më tepër palestra sportive në këtë rajon”. Në Viti/Vitina një burrë shkruan se “Rinia kosovare mund ti harrojë traumat e luftës vetëm nëse merret me sporte të

### **Të dhënat mbi kulturën**

· Kosova ka 14 muzeume, 56 biblioteka, 176 qendra kulturore, 3 teatro dhe 12 kinema, rreth 53% të tyre janë dëmtuar dhe 6% janë shkatërruar.\*

\* "Kosovo Building Assessment" International Management Group, April 2000.

ndryshme dhe aktivitete muzikore". Në Prishtinë/Pristina një dermatolog propozon, "Ne duhet tu ofrojmë më tepër sporte dhe aktivitete kulturore fëmijëve tanë ashtuqë ata të mos shkojnë nëpër diskoteka aq shpesh. Ne duhet ti udhëheqim të rinjtë tanë drejt aktiviteteve që do ti kontribuojnë shëndetit dhe mirëqenies së tyre. Gjithashtu na duhen më tepër debate në mes të shoqatave studentore për ti diskutuar problemet e tanishme dhe ti mësojmë ata si të komunikojnë përmes internetit. Mos të lejojmë që ata tërë kohën e tyre të lirë ta kalojnë në kafene".

## 15. Transporti publik

*Na duhen autobusë për mësues, nxënës dhe punëtorë.*

Një banor nga Kamenica/a

Edhe pse transporti publik nuk ishte prioritet i lartë, megjithatë ka rëndësi të madhe për disa individë. Ata që jetojnë në mjedise rurale tregojnë se si transporti është problem sepse pothuajse nuk funksionon derisa ata në rajone urbane nervozohen me moskoordinimin e transportit. Transporti publik në Kosovë operon me 20% të kapacitetit që kitshe para luftës<sup>3</sup> dhe shumë persona që jetojnë në mjedise më të izoluar e ndjejnë këtë më së shumti. Siç thotë një burrë nga Dragashi/Dragas, “në komunën tonë praktikisht nuk ka fare transport publik dhe dëshirojmë të bëjmë diçka në lidhje me këtë”. Po këtë vërejtje e bën edhe një ekonomist nga Skënderaj/Srbica duke thënë se mungesa e autobusëve krijon probleme për transportin ditor të fëmijëve për në shkollë. “Ne kemi nxënës që vijnë këtu nga fshatrat përreth”, thotë ai “dhe ata nuk kanë kurrfarë transporti publik. A mos duhet vallë ata të ecin për çdo ditë?”

Në qytete, banorët nuk kritikojnë mungesën e transportit publik, por karakterin konfuz dhe kaotik të transportit. Një banor nga Prishtina/Prishtina thotë se “transporti publik duhet të jetë më i organizuar dhe jo të jetë kaotik si është këtu” deri sa një tjetër nga Prishtina/Prishtina ankohet se trafiku është duke u keqësuar për shkak të minibusëve dhe të autobusëve që ndotin ambientin. Ata që mendojnë se kanë problem me transport publik dëshirojnë që udhëheqësit e tyre ta rivendosin një sistem të rregullt komunikacioni për të arritur deri tek fshatrat dhe ta rregullojnë transportin publik.

<sup>3</sup> Kosovo Consolidated Budget 1 January – 31 December 2000.

### Të dhënat për transportin publik

- Autobusët janë mënyra primare e transportit publik në Kosovë. Momentalisht ‘Kosova-Trans’-i operon me rreth 200 autobusë nëpër 12 qendra rajonale. 80% të autobusëve të kësaj ndërmarrjeje ishin shkatërruar gjatë luftës, prandaj nuk mund ta mbulojnë tërë Kosovën me shërbimet e tyre.
- Në Prishtinë/Prishtinë funksionojnë rreth 20 autobusë të ‘UrbanBus Prishtina’ (krahasuar me numrin e paraluftës që ishte 115 autobusë). Vlerësohet se rreth 500 autobusë privatë funksionojnë në Kosovë, së bashku me një numër të minibusëve dhe autobusëve të pa liqencuar (vlerësohet të jenë mbi 1,000).\*
- Kosova ka 330 kilometra hekurudhë, që përbëhen nga dy arterie kryesore që shkojnë veri-jug, dhe lindje-perendim. Dëmtimi i hekurudhës nga lufta ishte minimal. Mirëpo, sistemi hekurudhor ka nevojë për riparime të mëdha për shkak të mungesës së mirëmbajtjes adekuate. Para luftës, rreth 20 trena transportonin rreth 8.000 udhëtarë në ditë. Sot, dy trena për pasagjerë qarkullojnë nga Fushë Kosovë/Kosovo polje në Zveqan, dhe bartin rreth 800 pasagjerë në ditë.\*\*

\* “Kosovo: Reconstruction 2000” European Union/UNMIK Department of Reconstruction, April 2000 pp. 103

\*\* UNMIK Department of Transport and Infrastructure.

# Çështje shtesë

## Siguria dhe zbatimi i ligjit

*Jemi lodhur nga dhuna. Ka ardhur koha që Kosovën ta sundojë ligji.*

Një banor nga Malisheva/Malisevo

Janë disa çështje që nuk janë të përfshira në Rregulloren e UNMIK-ut për Vetëqeverisje të Komunave në Kosovë mirëpo shtrohen si shqetësime serioze komunale. Siguria, siguria publike dhe zbatimi i ligjit janë ato që u përmendën më së shumti. Nevoja për ta “ndalur dhunën” shpesh zihet në gojë.. Derisa policia civile e UNMIK-ut do ta mbajë përgjegjësinë për këto çështje, njerëzit besojnë se situata në bashkësitë e tyre doemos duhet të përmirësohet. Shumë syresh theksojnë se krimi është në rritje e sipër, kriminelët rrallë kapen, paligjshmëria është bërë endemike kurse siguria e popullit është në rrezik. “Krimi rritet për çdo ditë”, thotë një grua nga Gjakova/Djakovica, “dhe policia nuk është në gjendje të bëjë asgjë. Duhet që policia jonë që e njeh shoqërinë ti sjellë ata para drejtësisë”. Të tjerë pajtohen: “Që të ketë siguri”, thotë një burrë nga Malisheva/Malisevo, “ne duhet të kemi ligjshmëri dhe polici kosovare. Me gjithë respektin, mirëpo, policia nga vendet e ndryshme nuk ka njohin neve, nuk i njohin bashkësitë tona pra as gjuhën, zakonet dhe traditat tona. Prandaj është vështirë për ta që të na ndihmojnë në mënyrë efektive për ta luftuar krimin”. Një tjetër pajtohet dhe shton “Për të ecur përpara, na duhet sundimi i ligjit që në anën tjetër kërkon që Kosova ta ketë një kushtetutë, gjyqe që funksionojnë dhe polici”. Njerëzit dëshirojnë ta mënjanojnë elementin e frikës që është bërë pjesë e jetës së tyre të përditshme, “Të jemi të sigurtë, të ndalen vrasjet, vjedhjet dhe kidnapimet – me një fjalë ta kemi një jetë të qetë dhe të sigurtë – pa frikë” siç thotë një pensionist nga Prishtina/Pristina.

# Emancipimi i gruas

*Përparimi i Kosovës kërkon emancipimin e gruas*

Një burrë nga Gllgovci/Glogovac

Kur flitet për sigurinë dhe sundimin e ligjit shpesh zihet në gojë dhuna ndaj gruas dhe të drejtat e gruas. “Në këtë kohë”, shkruan një profesor nga Gjakova/Djakovica, “dhuna është në rritje e sipër. Ne nuk kemi ligje që do të mund të mbronin gratë dhe ato nuk kanë të drejta që u takojnë. Kërkesa ime drejtuar udhëheqësve tanë është që të punojnë më tepër në këtë drejtim”. Edhe të tjerë pajtohen dhe besojnë se pozita e gruas në Kosovë duhet të shqyrtohet në mënyrë shumë kritike. Disa femra tregojnë për diskriminimin e tyre në vendin e punës dhe kërkojnë që të trajtohen në mënyrë të barabartë nga punëdhënësit. Një grup tepër i zëshëm i burrave nga Gllgovci/Glogovac përkujtojnë se “tradicionalisht, femrat kanë pasur një nivel shumë të ulët të arsimit në Kosovë. Ne jemi të vetëdijshëm se pa emancipimin e gruas, shoqëria nuk mund të lëvizë para”. Duhet të ketë përparim në këtë çështje, shtojnë ata, nëse duam “që femrat të kenë të drejtat e barabarta me meshkujt”.

# Pikëpamjet e pakicave

*Nuk mund të lëvizim më tepër se njëzet metra nga ndërtesa ynë.*

Një serb nga Prishtina/Pristina

Rreth 15 % të mbledhjeve të Zërit të Votuesve përbëheshin ekskluzivisht nga pjesarë të pakicave kombëtare. Ndërkohë që dallimi në interesat e tyre është i dukshëm në disa nga prioritetet plotësuese që ata shpalosin siç është siguria, liria e lëvizjes dhe qasje e sigurtë dhe e barabartë në shkolla dhe në shërbimin shëndetësor, pra një numër shqetësimesh të pakicave janë të ngjashme me ato të pjesës tjetër të popullatës. Kujdesi shëndetësor është çështja më prioritare e përcaktuar nga grupet minoritare, pason zhvillimi ekonomik dhe punësimi, uji, mbrojtja e pakicave dhe rryma elektrike. Edhe pse këto çështje janë të ngjajshme me ato në tërë Kosovën (me përjashtim të mbrojtjes së pakicave), megjithatë shpeshherë këndi nga i cili ato shikohen është krejtësisht i ndryshëm, siç shtjellohet më poshtë. Në këtë pjesë pasqyrohen pikëpamjet e pakicave pasi nuk janë shpalosur në pjesët e tjera të këtij botimi. Nuk mund të thuhet se ky është një anketim gjithëpërfshirës i prioriteteve të pakicave e as që ka për qëllim të përfaqësojë tërë popullatën minoritare kosovare me llojllojshmërinë dhe karakteristikat dalluese të saj. Por, qëllimi është që të theksohen çështjet për të cilat pakicat kanë pikëpamje të ndryshme, apo që të përmenden çështjet që nuk janë nën kompetencat e shënuara në Rregulloren e UNMIK-ut për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë.

## **Kujdesi shëndetësor**

Përkujdesja shëndetësore është çështje prioritare për pakicat për shumë arsye të ngjashme me ato të pjesës tjetër të popullatës. Njerëzit përmendin problemet siç janë spitalet e stërbushura, niveli i ulët i higjienës, barërat dhe shërbimet e shtrenjta si dhe pajisjet e vjetra. Dallimi kryesor qëndron në komentet e tyre për qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore. Vërejtjet më të shpeshta të tyre janë që spitalet kanë shtrirje tepër të vogël dhe largësitë që disa pakica duhet ti kalojnë – disa madje deri në Serbi – për trajtim mjekësor. Një serb nga Rahoveci/Orahovac shkruan “ne duhet ta përmirësojmë shërbimin shëndetësor duke hapur shtëpi shëndeti që mund ti përdorim, të punësojmë specialistë të çdo lloji dhe të kemi ilaçe të mjaftueshme për të gjithë pacientët”, derisa

një rom, banor i Gračanica thotë se për shkak të situatës së sigurisë dhe frikës për të udhëtuar në Prishtinë/Pristina ai duhet të shkojë në Nis h (Serbi) për një vizitë në spital. Grupet minoritare gjithashtu kërkojnë siguri të mjaftueshme për të vizituar spitalet e afërta, ose hapjen e më shumë shtëpive të shëndetit nëpër fshatrat e tyre pasi aty ndjehen të sigurtë për të shfrytëzuar ato.

## **Zhvillimi ekonomik dhe punësimi**

Sikurse edhe pjesa tjetër e Kosovës, pjesëtarët e pakicave e shohin ekonominë dhe mungesën e vendeve të punës si prioritet të rëndësishëm i cili duhet të zgjidhet. Anëtarët e bashkësisë romë në Graçanicë brengosen për numrin e lartë të romëve që janë të papunë. “Ne romët që kemi mbetur në Graçanicë”, thotë një banor, “do të pranojmë çfarëdo pune. Duhet ti mbajmë familjet tona.” Të tjerë romë vendosmërisht tregojnë se ata janë të diskriminuar kur kërkojnë punë. Serbët në Rahovec/Orahovac brengosen për mundësitë e vogla për tu punësuar derisa një banor serb nga Prishtina/Pristina thotë se “detyra jonë e parë është ringjallja e ekonomisë”.

## **Siguria dhe liria e lëvizjes**

Të tjera çështje që përmenden nga grupe minoritare dhe të cilat i radhiten lartë janë siguria dhe liria e lëvizjes. Siguria shpesh përmendet si prioritet tejet i lartë në mesin e pjesëmarrësve serbë dhe romë. Edhe kur ata e kanë mundësinë që të lëvizin jashtë enklavave të tyre, ata tregojnë për frikën e përditshme për të ecur apo për të vizituar miqtë, apo që ti kryejnë funksionet ditore si furnizimi me ushqime apo marrja e recetave në barnatore. Në lagjen Ulpiana të Prishtinës/Pristina ata përmendin incidentet si hedhja e gurëve apo e mbeturinave në kompleksin e tyre të apartamenteve derisa në Rahovec/Orahovac ata frikohen edhe nga sulmet. Niveli i shtuar i dhunës është shqetësim në tërë Kosovën; mirëpo grupet minoritare në veçanti frikësohen nga sulme apo kidnapime të motivuara etnikisht. “Numri i madh i kidnapimeve dhe i sulmeve”, thotë një serb nga Rahoveci/Orahovac “kanë shkaktuar që serbët vazhdimisht të ikin sepse nuk ndihen të sigurtë”. Çështjet e sigurisë janë gjithashtu temë e rëndësishme për anëtarët e bashkësisë romë: “Një numër më i madh i policëve mund ta zvogëlojë krimin dhe dhunën”, shkruan një burrë nga Klina/a dhe të tjerë pajtohen se siguria duhet të jetë njëra nga prioritetet kryesore.

Liria e lëvizjes është gjithashtu çështje e theksuar sidomos nga pjesëmarrësit serbë. “Serbët në Rahovec/Orahovac”, shkruan një banor “jetojnë në një pjesë të keqe të qytetit që përthekon një sipërfaqe prej më pak se 1000 kilometrash katrorë. Çdo tentim për tu larguar nga aty mund të rezultojë me ndonjë kidnapim kështu që e vetmja mënyrë për tu larguar është me përcjellje ndërkombëtare”. Ata kërkojnë që tu mundësohet që të lëvizin lirshëm në rrugë, ti vizitojnë miqtë dhe familjen e gjërë në enklavat serbe apo në Serbi. “Nuk mund të lëvizim më tepër se njëzet metra nga ndërtesa ynë”, shkruan një serb nga Prishtina/Pristina. “Në kërkojmë që të na mundësohet që ta lëshojmë Prishtinën/Pristina dhe të kthehemi atëherë kur këtu të ketë siguri”. Një rom nga Prishtina/Pristina shton, “ne duhet të kemi liri të lëvizjes, të mundemi të lëvizim pa frikë dhe kujdes”. Liria e lëvizjes për disa do të thotë liri për ta përdorur transportin publik brenda Kosovës sepse disa nga pjesëtarët e pakicave thonë se nuk guxojnë ta përdorin transportin publik nga frika e kërcënimeve. Banorët serbë



they mention feelings of everyday insecurity and fear; fear while walking on the streets, fear while visiting friends, fear while performing every day chores such as shopping for groceries or picking up prescriptions at the pharmacy. In Ulpiana, Prishtina/Pristina they mention incidents such as stoning or being pelted with garbage within their apartment complex, while in Rahovec/Orahovac people are afraid of violent assault. Rising levels of violence are a concern across Kosovo; however, the minority groups in particular fear the continued ethnically motivated attacks and kidnappings. "The numerous abductions and arsons," states a Serb from Rahovec/Orahovac "have caused Serbs to move out on a perpetual basis because they do not feel safe." Security issues are also a concern for members of the Roma population: "Increasing police can minimise crime and violence," writes a man from Kline/Klina and others agree, listing security as one of their main priorities.

Freedom of movement is another issue stressed by the Serb participants in particular. "Serbs in Rahovec/Orahovac," writes an inhabitant "live in a ghetto in an area of less than 1000 square meters. Any attempt to leave can result in abduction so the only way to move from the territory of the ghetto is with an international escort." They ask to be able to move freely on the streets, to visit relatives and friends in Serb enclaves as well as relatives in Serbia. "Our movement is limited to twenty feet in front of our building," writes a Serb resident of Prishtina/Pristina. "We want to be able to leave and return to Prishtina/Pristina in safety." A Roma from Prishtina/Pristina adds, "we need to have freedom of movement, to be able to move without fear and caution." Freedom of movement for some translates into freedom to use public transportation within Kosovo and some minority members remark that they are wary of using local public transport for fear of ethnic intimidation. Serb residents of Ajnovce maintain that they lack freedom of movement because the bus from Kamenice/Kamenica will not continue on to the Serb area. One man claims however, even if it did, "the people are too scared to take public transport anyway because they have experienced provocation, and the fees are in DM instead of Dinar."

Other issues raised exclusively by the Serb participants are the return of displaced Serbs, and the freedom to sell or use their property. Finally; all minority groups express the feeling that inter-ethnic relations must find some sort of balance within Kosovo. "First of all," writes a man from the Serb quarter of Rahovec/Orahovac "we must establish respect for human rights in Kosovo for all ethnicities." The call for ethnic tolerance and general weariness of the current tense situation is evident in many people's remarks, as they look towards a more hopeful vision of the future. "In my opinion," states a Serb from Rahovec/Orahovac, "we should work with the Albanians to do everything possible to bring life back to normal."

## Prioritetet sipas Regjioneve

	<b>Prizren</b>	<b>Mitrovicë/a</b>	<b>Prishtinë/Pristina</b>	<b>Pejë/Pec</b>	<b>Gjilan/Gnjilane</b>
<b>1</b>	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor	Arsimi	Arsimi
<b>2</b>	Arsimi	Arsimi	Arsimi	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor
<b>3</b>	Zhvillimi ekonomik/Punësimi	Sigurimi social	Zhvillimi ekonomik/Punësimi	Zhvillimi ekonomik/Punësimi	Zhvillimi ekonomik /Punësimi
<b>4</b>	Uji	Strehimi	Uji	Strehimi	Sigurimi social
<b>5</b>	Sigurimi social	Zhvillimi ekonomik/Punësimi	Strehimi	Sigurimi social	Rryma elektrike
<b>6</b>	Rryma elektrike	Uji	Rryma elektrike	Uji	Uji
<b>7</b>	Rrugët	Rryma elektrike	Sigurimi social	Rryma elektrike	Mbrojtja e ambientit
<b>8</b>	Strehimi	Rrugët	Rrugët	Rrugët	Rrugët
<b>9</b>	Mbrojtja e ambientit	Mbeturinat	Mbrojtja e ambientit	Mbrojtja e ambientit	Mbeturinat
<b>10</b>	Kanalizimi	Kanalizimi	Mbeturinat	Mbrojtja e pakicave	Strehimi
<b>11</b>	Telekomunikimi dhe posta	Mbrojtja e ambientit	Kanalizimi	Mbeturinat	Kultura
<b>12</b>	Mbrojtja e pakicave	Kultura	Mbrojtja e pakicave	Telekomunikimi dhe posta	Telekomunikimi dhe posta
<b>13</b>	Mbeturinat	Telekomunikimi dhe posta	Telekomunikimi dhe posta	Kultura	Kanalizimi
<b>14</b>	Kultura	Mbrojtja e pakicave	Kultura	Kanalizimi	Mbrojtja e pakicave
<b>16</b>	Transporti publik	Transporti publik	Transporti publik	Transporti publik	Transporti publik

# Përmbajtja

1. Pasqyrë përmbledhëse .....	5
2. Parathënie .....	3
3. Hyrje .....	9
4. Prioritetet e votuesve .....	11
· Shëndetësia .....	12
· Arsimi .....	16
· Zhvillimi ekonomik/punësimi .....	20
· Uji .....	23
· Shërbimet Sociale .....	26
· Rryma .....	29
· Banimi .....	31
· Rrugët .....	33
· Ambienti .....	35
· Mbeturinat .....	37
· Kanalizimi .....	39
· Mbrojtja e pakicave .....	40
· Telekomunikimi/Posta .....	42
· Kultura .....	43
· Transporti publik .....	45
· Çështje të tjera të hapura .....	46
6. Pikëpamjet e pakicave .....	48
7. Aneks: Prioritetet sipas rajoneve .....	51